FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.82 17 qershor 2011

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.10 428 datë 2.6.2011	Për të drejtën ndërkombëtare private	3319
Vendim i Kuvendit nr.102, datë 16.6.2011	Për dhënien e pëlqimit për emërimin e zotit Edmond Islamaj anëtar i Gjykatës së Lartë	3340
Vendim i Kuvendit nr.103, datë 16.6.2011	Për mosdhënien e pëlqimit për emërimin e zonjës Manjola Bejleri anëtare e Gjykatës së Lartë	3340
Vendim i Kuvendit nr.104, datë 16.6.2011	Për dhënien e pëlqimit për emërimin e zotit Shkëlzen Selimi anëtar i Gjykatës së Lartë	3341
Vendim i Kuvendit nr.105, datë 16.6.2011	Për zgjedhjen e zotit Alfred Prifti anëtar i Komisionit të Shërbimit Civil	3341
Vendim i KM nr.406, datë 8.6.2011	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.413, datë 26.5.2010 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strukturës e të organikës, si dhe të strukturës e të niveleve të pagave të Autoritetit të Aviacionit Civil".....	3342
Udhëzim i MF nr.12/2, datë 15.6.2011	Për disa shtesa në udhëzimin nr.12, datë 18.5.2011 "Për procedurat e zbatimit të ligjit nr.10418, datë 21.4.2011 "Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor"", të ndryshuar	3344
Vendim i GJK nr.21, datë 3.6.2011	Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor si rezultat i moszbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr.79, datë 10.6.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë.....	3344

Vendim i GJK nr.22, datë 6.6.2011	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.980, datë 1.8.2007 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të vendimit nr.1177, datë 16.10.2009 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën	3348
Vendim i GJK nr.23, datë 8.6.2011	Me objekt shfuqizimin e nenit 15/a të ligjit nr.9794, datë 23.7.2007 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", si të papajtueshëm me Kushtetutën.....	3352

LIGJ
Nr.10 428, datë 2.6.2011

PËR TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE PRIVATE[1]

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

1. Ky ligj përcakton:

a) rregullat për ligjin që zbatohet në marrëdhëniet juridike civile, të cilat kanë elemente të huaja;

b) juridiksionin dhe rregullat procedurale të gjykatave shqiptare për marrëdhëniet juridike civile, të cilat kanë elemente të huaja.

2. "Elementi i huaj", për qëllime të zbatimit të këtij ligji, nënkupton çdo rrethanë juridike që lidhet me subjektin, përmbajtjen ose objektin e një marrëdhënieje juridiko-civile dhe që bëhet shkak për lidhjen e kësaj marrëdhënieje me një sistem ligjor të caktuar.

Neni 2
Epërsia e marrëveshjeve ndërkombëtare

Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj kanë epërsi mbi dispozitat e këtij ligji, kur dispozitat e tij nuk pajtohen me to.

Neni 3
Referimi në ligjin e një shteti tjetër

1. Kur ky ligj referon në ligjin e një shteti tjetër, zbatohen edhe rregullat e së drejtës private ndërkombëtare të atij shteti. Kur rregullat e atij shteti referojnë në ligjin shqiptar, zbatohen rregullat e këtij të fundit, përveçse kur ligji parashikon ndryshe. Kur ligji i një shteti të huaj referon në ligjin e një shteti të tretë, zbatohet ligji i këtij të fundit.

2. Rregullat e së drejtës ndërkombëtare private të një shteti tjetër nuk zbatohen në lidhje me:

a) statusin e personave juridikë;

b) zgjedhjen e ligjit të zbatueshëm;

c) formën e veprimit juridik;

ç) detyrimin ushqimor;

d) detyrimet kontraktore;

dh) detyrimet jashtëkontraktore.

---

[1] Rregullore (EC) nr.593/2008 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit "Mbi ligjin e zbatueshëm për detyrimet kontraktore";
Rregullore (EC) nr.864/2007 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit "Mbi ligjin e zbatueshëm për detyrimet jashtëkontraktore".

Neni 4
Referimi në ligjin e shtetit që ka disa sisteme ligjore

Kur një shtet ka disa sisteme ligjore të zbatueshme mbi baza territoriale ose personale, çdo referim në ligjin e atij shteti është referim në sistemin ligjor të përshkruar nga rregullat në fuqi në atë vend. Në mungesë të këtyre rregullave, zbatohet ai sistem ligjor, me të cilin objekti i çështjes ka lidhjen më të ngushtë.

Neni 5
Përcaktimi i ligjit të huaj

1. Gjykata njihet kryesisht me përmbajtjen e ligjit të huaj që zbatohet. Përveç instrumenteve të përcaktuara në konventat ndërkombëtare dhe informacioneve të siguruara nga Ministria e Drejtësisë, për këtë qëllim mund të thirren ekspertë ose institucione të specializuara.

2. Palët gjatë procesit mund të sigurojnë dokumente të vërtetuara nga organet kompetente të shtetit tjetër, lidhur me dispozitat e ligjit të huaj, të kërkuar.

3. Kur gjykata nuk arrin të njohë as kryesisht dhe as me ndihmën e palëve përmbajtjen e ligjit të huaj, ajo zbaton ligjin shqiptar.

Neni 6
Interpretimi dhe zbatimi i ligjit të huaj

Ligji i huaj interpretohet dhe zbatohet në pajtim me kriteret për interpretimin dhe zbatimin në shtetin e origjinës.

Neni 7
Përjashtimi për shkak të rendit publik

Ligji i huaj nuk zbatohet kur efektet e zbatimit të tij janë dukshëm në kundërshtim me rendin publik apo mund të sjellin pasoja, të cilat janë haptazi të papajtueshme me parimet themelore, të përcaktuara në Kushtetutë dhe në ligjin shqiptar. Në rast papajtueshmërie, zbatohet një dispozitë tjetër e përshtatshme, që i përket së drejtës së shtetit të huaj dhe, kur kjo mungon, zbatohet ligji shqiptar.

KREU II
SUBJEKTET E SË DREJTËS

SEKSIONI I
Personat fizikë

Neni 8
Personi me disa shtetësi

1. Nëse shtetasi shqiptar ka edhe shtetësi të ndonjë shteti tjetër, për qëllim të zbatimit të këtij ligji, shtetësia shqiptare ka epërsi.

2. Nëse shtetasi i huaj ka dy ose më shumë shtetësi, zbatohet ligji i shtetit të shtetësisë, në të cilin ky person ka vendqëndrimin e tij të zakonshëm.

3. Nëse shtetasi i huaj nuk ka vendqëndrim të zakonshëm në asnjë prej shteteve, shtetësinë e të cilave mban, për efekt të zbatimit të këtij ligji, konsiderohet se ai ka shtetësinë e shtetit, me të cilin ka lidhje më të ngushta.

Neni 9
Personi pa shtetësi

1. Kur personi është pa shtetësi ose shtetësia e tij nuk mund të përcaktohet, zbatohet ligji i shtetit, në të cilin ky person ka vendqëndrimin e zakonshëm.

2. Kur personi nuk ka vendqëndrim të zakonshëm apo ky nuk mund të përcaktohet, zbatohet ligji i shtetit, me të cilin ky person ka lidhjen më të ngushtë.

Neni 10
Zotësia juridike

Zotësia juridike e personit fizik rregullohet nga ligji i shtetit, shtetësinë e të cilit ai ka.

Neni 11
Zotësia për të vepruar

1. Zotësia për të vepruar e personit fizik dhe kufizimi apo heqja e zotësisë për të vepruar rregullohen nga ligji i shtetit, shtetësinë e të cilit ai ka.

2. Nëse zotësia për të vepruar është fituar një herë, ajo nuk humbet për shkak të ndryshimit të shtetësisë.

3. Kur një kontratë lidhet ndërmjet personave, që ndodhen në të njëjtin shtet, një person fizik, i cili, në bazë të ligjit të këtij shteti, ka zotësi për të vepruar, mund të pretendojë pazotësinë e tij për të vepruar në bazë të një ligji tjetër, vetëm kur pala tjetër kontraktore ka pasur dijeni për pazotësinë për të vepruar, ose nuk ka pasur dijeni për shkak të pakujdesisë në kohën e lidhjes së kontratës.

Neni 12
Vendqëndrimi i zakonshëm dhe lidhjet më të ngushta

1. Për qëllime të këtij ligji, me "vendqëndrim të zakonshëm të një personi fizik" kuptohet vendi, në të cilin ai ka vendosur për të qëndruar në pjesën më të madhe të kohës, qoftë dhe në mungesë të regjistrimit dhe pavarësisht nga leja apo autorizimi për të qëndruar. Në përcaktimin e këtij vendi gjykata mban parasysh rrethanat e natyrës personale apo profesionale, që tregojnë lidhje të qëndrueshme me këtë vend, apo synimin e personit për të krijuar lidhje të tilla.

2. Për qëllime të këtij ligji, lidhja më e ngushtë përcaktohet nga gjykata, sipas rrethanave të faktit.

Neni 13
E drejta e emrit

1. Emri, emrat e ndërmjetëm dhe mbiemri i personit, si dhe ndryshimi i tyre rregullohen nga ligji i shtetit, shtetas i të cilit ai është.

2. Emri, emrat e ndërmjetëm dhe mbiemri i personit, si dhe ndryshimi i tyre rregullohen nga ligji shqiptar, nëse kjo kërkohet nga një person, i cili ka vendqëndrimin e tij të zakonshëm në Shqipëri.

Neni 14
Shpallja e zhdukjes dhe e vdekjes së një personi fizik

1. Kushtet dhe pasojat për shpalljen të zhdukur ose të vdekur të një personi rregullohen nga ligji i shtetit, shtetësinë e të cilit ka pasur ky person në ditën e lajmeve të fundit për të.

2. Në qoftë se personi në këtë kohë ka qenë shtetas i një shteti tjetër dhe ka vendqëndrimin e zakonshëm në Shqipëri, ai mund të deklarohet i zhdukur ose i vdekur, sipas ligjit shqiptar, në qoftë se ekziston një interes i ligjshëm për këtë.

SEKSIONI II

Personat juridikë, shoqatat dhe organizatat pa personalitet juridik

Neni 15

Personat juridikë

1. Personat juridikë rregullohen nga ligji i shtetit, në të cilin janë regjistruar.

2. Në veçanti, përcaktohen nga ligji rregullues i personit juridik:

a) natyra juridike;

b) themelimi, transformimi dhe mbarimi;

c) zotësia juridike dhe ajo për të vepruar;

ç) emri i personit juridik;

d) struktura, kompetencat dhe mënyra e funksionimit të organeve drejtuese të personit juridik;

dh) përfaqësimi i personit juridik;

e) mënyra dhe forma, sipas së cilave fitohet apo humbet anëtarësia apo e drejta për të qenë ortak, si dhe të drejtat e detyrimet që burojnë prej tyre;

ë) përgjegjësia e personit juridik, e drejtuesve dhe e anëtarëve të saj për detyrimet ndaj të tretëve;

f) pasojat e shkeljes së ligjit apo të aktit të themelimit.

Neni 16

Shoqatat dhe organizatat pa personalitet juridik

Shoqatat dhe organizatat pa personalitet juridik rregullohen nga ligji i shtetit, në të cilin janë organizuar. Për mënyrën e rregullimit të tyre zbatohen dispozitat e pikës 2 të nenit 15 të këtij ligji.

Neni 17

Vendqëndrimi i zakonshëm

1. Për qëllime të këtij ligji, vendqëndrim i zakonshëm i personit juridik, i shoqatave apo organizatave pa personalitet juridik është vendi ku ndodhet selia qendrore. Vendqëndrimi i zakonshëm i një personi fizik, që ushtron veprimtari biznesi, është vendi i tij kryesor i biznesit.

2. Kur kontrata lidhet gjatë operacioneve të një dege, agjencie a institucioni tjetër ose, nëse sipas kontratës, përmbushja është përgjegjësi e kësaj dege, agjencie ose institucioni, vendi ku ndodhet dega, agjencia ose një institucion tjetër trajtohet si vendi i vendqëndrimit të zakonshëm.

3. Për qëllimet e përcaktimit të vendqëndrimit të zakonshëm, momenti përkatës në kohë është koha e lidhjes së kontratës.

KREU III

VEPRIMET JURIDIKE

Neni 18

Forma e veprimit juridik

1. Veprimi juridik është i vlefshëm, nëse përmbush kriteret e formës, sipas ligjit të shtetit, në të cilin është kryer veprimi juridik, ose kriteret e përcaktuara, sipas ligjit, i cili rregullon përmbajtjen e veprimit juridik.

2. Veprimi juridik, i lidhur midis personave, të cilët ndodhen në shtete të ndryshme, ka formë të vlefshme, nëse ai përmbush kriteret e të paktën njërit prej këtyre shteteve.

3. Veprimi juridik, i cili ka për objekt sende të paluajtshme, rregullohet nga ligji i shtetit, në të cilin ndodhet sendi i paluajtshëm.

Neni 19
Përfaqësimi vullnetar

1. Marrëdhëniet ndërmjet përfaqësuesit dhe të përfaqësuarit rregullohen nga ligji i zgjedhur mes tyre.

2. Kur ky ligj nuk është zgjedhur sipas pikës 1 të këtij neni, ligji i zbatueshëm është ligji i shtetit, ku, në kohën e krijimit të marrëdhënies së përfaqësimit vullnetar, përfaqësuesi ka vendin e tij të punës ose, kur nuk ka asnjë të tillë, vendqëndrimin i tij zakonshëm.

Megjithatë, nëse përfaqësuesi vepron duke ushtruar veprimtarinë profesionale të tij, përfaqësimi rregullohet sipas ligjit të shtetit, në të cilin përfaqësuesi ka qendrën e ushtrimit të kësaj veprimtarie, nëse kjo është e njohur ose mund të njihet nga një i tretë.

3. Në marrëdhëniet ndërmjet të përfaqësuarit dhe palës së tretë, ekzistenca dhe shtrirja e tagrave të përfaqësuesit dhe efektet e ushtrimit nga përfaqësuesi apo ushtrimi i synuar i këtyre tagrave prej tij rregullohen nga ligji i shtetit, në të cilin ky përfaqësues ka qendrën e ushtrimit të kësaj veprimtarie në kohën e kryerjes së akteve përkatëse.

Neni 20
Parashkrimi i të drejtave

Parashkrimi i të drejtave rregullohet nga ligji i shtetit, i cili rregullon këtë pretendim.

KREU IV
DISPOZITA PËR MARTESËN DHE FAMILJEN

Neni 21
Kushtet për lidhjen e martesës

1. Kushtet për lidhjen e martesës rregullohen nga ligji i shtetit, shtetësinë e të cilit ka secili prej bashkëshortëve të ardhshëm në kohën e lidhjes së martesës.

2. Shtetasit e huaj apo pa shtetësi, që lidhin martesë në territorin e Republikës së Shqipërisë, duhet të përmbushin edhe kushtet thelbësore për lidhjen e martesës, sipas përcaktimeve të Kodit të Familjes.

3. Nëse, sipas ligjit që duhet të zbatohet në përputhje me pikën 1 të këtij neni, mungon ndonjë nga kushtet për lidhjen e martesës, martesa mund të lidhet sipas ligjit shqiptar, kur njëri prej bashkëshortëve është shqiptar ose ka vendqëndrimin e zakonshëm në Shqipëri.

4. Një martesë e lidhur sipas pikës 1 të këtij neni mund të njihet në Shqipëri, nëse plotëson kushtet për lidhjen e martesës, sipas ligjit shqiptar.

Neni 22
Forma e lidhjes së martesës

1. Forma e lidhjes së martesës rregullohet nga ligji i shtetit ku lidhet martesa.

2. Martesa ndërmjet personave, ku asnjëri prej tyre nuk është shtetas shqiptar, mund të lidhet para përfaqësisë diplomatike apo konsullore të një shteti të huaj, nëse ligji i këtij shteti e lejon këtë.

3. Forma e lidhjes së martesës, e cila konsiderohet e vlefshme në bazë të ligjit të shtetit, sipas të cilit është lidhur, mund të njihet si e tillë edhe në Republikën e Shqipërisë.

Neni 23
Marrëdhëniet personale të bashkëshortëve

1. Marrëdhëniet personale të bashkëshortëve rregullohen nga ligji i shtetësisë së përbashkët.

2. Nëse bashkëshortët kanë shtetësi të ndryshme, zbatohet ligji i shtetit, në të cilin ata kanë vendqëndrimin e përbashkët.

3. Nëse ligji i zbatueshëm nuk mund të përcaktohet sipas pikës 1 ose 2 të këtij neni, zbatohet ligji i shtetit, me të cilin marrëdhënia bashkëshortore ka lidhjen më të ngushtë.

Neni 24

Regjimi pasuror martesor

1. Regjimi pasuror martesor përcaktohet nga ligji i shtetit, që rregullon marrëdhëniet personale të bashkëshortëve. Ndryshimi i regjimit pasuror nuk prek të drejtat e fituara më parë nga bashkëshortët.

2. Bashkëshortët, në marrëveshje midis tyre, të bërë me akt noterial apo me akt tjetër të barasvlershëm dhe të lëshuar nga një organ publik, mund të vendosin që për regjimin pasuror martesor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, të zbatohet ligji i shtetit:

a) shtetësinë e të cilit ka njëri nga bashkëshortët;

b) në të cilin ka vendqëndrimin e tij të zakonshëm njëri nga bashkëshortët;

c) në të cilin ndodhet pasuria e paluajtshme.

3. Kur regjimi pasuror martesor rregullohet nga ligji i huaj, i përcaktuar sipas pikës 2 të këtij neni, pretendimet, që lindin në lidhje me vlefshmërinë e marrëveshjes, kanë pasoja ndaj një të treti, vetëm nëse ai e dinte ekzistencën e këtij fakti ose nuk ka qenë në dijeni të tij për fajin e vet.

Neni 25

Zgjidhja e martesës

1. Zgjidha e martesës rregullohet nga ligji i shtetësisë së bashkëshortëve në kohën e paraqitjes së padisë. Kur bashkëshortët kanë shtetësi të ndryshme, zgjidhja e martesës rregullohet nga ligji i shtetit, në territorin e të cilit bashkëshortët kanë vendqëndrimin e zakonshëm të tyre ose vendqëndrimin e fundit të përbashkët në kohën e paraqitjes së padisë.

2. Kur ligji i përcaktuar, sipas pikës 1 të këtij neni, nuk lejon zgjidhjen e martesës, ajo bëhet në përputhje me ligjin shqiptar, nëse kërkuesi është një shtetas shqiptar ose ka qenë shtetas shqiptar në kohën e lidhjes së martesës.

Neni 26

Detyrimi për ushqim

1. Detyrimi për ushqim rregullohet nga ligji i shtetit, në të cilin personi, që ka të drejtën e përfitimit të këtij detyrimi (kreditori), ka vendqëndrimin e zakonshëm në kohën kur e kërkon atë.

2. Kur debitori dhe kreditori kanë shtetësi të njëjtë dhe debitori ka vendqëndrimin e zakonshëm në këtë shtet, zbatohet ligji i shtetësisë së tyre.

3. Kur kreditori nuk përfiton të drejtën për ushqim, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, zbatohet ligji shqiptar.

4. Kur martesa është zgjidhur ose është shpallur e pavlefshme në Republikën e Shqipërisë apo kur vendimi për zgjidhjen a shpalljen e pavlefshme të saj është njohur në Republikën e Shqipërisë, detyrimi për ushqim rregullohet nga ligji i shtetit, që është zbatuar për zgjidhjen ose për shpalljen e pavlefshme të saj.

Neni 27

Fusha e ligjit të zbatueshëm për detyrimin ushqimor

1. Ligji i zbatueshëm për detyrimin ushqimor përcakton në veçanti:

a) masën dhe kreditorin, prej të cilit mund të kërkohet detyrimi ushqimor;

b) personin që ka të drejtë të paraqesë padi dhe afatet e paraqitjes së saj;

c) shkakun dhe kushtet kur mund të ndryshojë detyrimi ushqimor;

ç) masën e detyrimit të debitorit, kur një institucion shtetëror, i cili ka paguar detyrimin ushqimor kreditorit, kërkon kthimin e shpenzimeve.

2. Në përcaktimin e shumës së detyrimit ushqimor merren parasysh aftësia paguese e debitorit dhe nevojat e kreditorit edhe nëse ligji i zbatueshëm parashikon ndryshe.

Neni 28
Atësia dhe amësia

1. Njohja dhe kundërshtimi i atësisë dhe amësisë së fëmijës rregullohen nga ligji i shtetit, shtetësinë e të cilit ka fëmija në kohën e lindjes, ose kur kjo njohje rezulton nga një akt i vullnetshëm në kohën e këtij akti.

2. Pavarësisht nga përmbajtja e pikës 1 të këtij neni, nëse është në interesin më të lartë të fëmijës, mund të zbatohet:

a) ligji i shtetit, ku fëmija ka vendqëndrimin e zakonshëm në kohën paraqitjes së kërkesës;

b) ligji që zbatohet për marrëdhëniet personale ndërmjet prindërve në kohën e lindjes.

Neni 29
Marrëdhëniet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve

Marrëdhëniet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve rregullohen nga ligji i shtetit, ku fëmija ka vendqëndrimin e zakonshëm, ose ligji i shtetësisë së fëmijës, kur ai mund të jetë në interesin më të lartë të fëmijës.

Neni 30
Birësimi

1. Kushtet për birësim dhe përfundimi i tij rregullohen nga ligji i shtetit, shtetësinë e të cilit kanë birësuesit në kohën e birësimit.

2. Nëse birësuesit kanë shtetësi të ndryshme, birësimi rregullohet nga ligji i shtetit, në të cilin birësuesit kanë vendqëndrimin e përbashkët.

3. Në çdo rast, birësimi nuk duhet të cenojë rastet e ndalimit të birësimit ndërvendas, sipas përcaktimeve të Kodit të Familjes.

Neni 31
Efektet e birësimit

1. Efektet e birësimit rregullohen nga ligji i shtetit, shtetësinë e të cilit kanë birësuesit në kohën e birësimit.

2. Nëse birësuesit kanë shtetësi të ndryshme, efektet e birësimit rregullohen nga ligji i shtetit, në të cilin birësuesit kanë vendqëndrimin e zakonshëm të përbashkët.

Neni 32
Kujdestaria

1. Vendosja në kujdestari, ndryshimi i kujdestarit, pushimi i kujdestarisë, si dhe masa të tjera të ndërmarra në kuadrin e saj mbi një person ose pasurinë e tij rregullohen nga ligji i shtetit, shtetësinë e të cilit ka personi mbi të cilin është vendosur kujdestaria.

2. Shtetasi i huaj ose personi pa shtetësi, i cili ka vendqëndrimin e tij të zakonshëm në Republikën e Shqipërisë, vendoset në kujdestari të përkohshme, sipas ligjit shqiptar, derisa shteti përkatës të vendosë dhe të marrë masat e nevojshme.

3. Pasuria, që ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë, në pronësi të një shtetasi të huaj ose pa shtetësi, vendoset në kujdestari të përkohshme, sipas ligjit shqiptar, derisa shteti tjetër të vendosë dhe të marrë masat e nevojshme.

KREU V
TRASHËGIMIA

Neni 33
Ligji i zbatueshëm

1. Trashëgimia e sendeve të luajtshme rregullohet nga ligji i shtetit, në të cilin trashëgimlënësi ka vendqëndrimin e tij të zakonshëm në kohën e vdekjes.

2. Trashëgimia mbi sendet e paluajtshme rregullohet nga ligji i shtetit, në territorin e të cilit ndodhet sendi i paluajtshëm.

3. Trashëgimlënësi mund të zgjedhë si ligj të zbatueshëm për gjithë trashëgiminë e tij ligjin e një shteti të caktuar. Zgjedhja e ligjit ka efekt vetëm nëse në kohën e përcaktimit të tij apo të vdekjes, trashëgimlënësi ishte shtetas i atij shteti ose kishte vendqëndrimin e zakonshëm të tij në këtë shtet. Zgjedhja e ligjit nuk mund të ketë si pasojë privimin e një trashëgimtari nga e drejta e rezervës ligjore, që i takon nga ligji i zbatueshëm, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni.

4. Zgjedhja, revokimi ose ndryshimi i ligjit të zbatueshëm bëhen sipas rregullave për formën që zbatohet për revokimin e disponimit testamentar.

Neni 34
Zotësia për të disponuar me testament

Zotësia për të disponuar me testament rregullohet nga ligji i shtetit, shtetësinë e të cilit ka testamentlënësi në kohën e bërjes, ndryshimit ose revokimit të testamentit.

Neni 35
Vlefshmëria e testamentit

1. Testamenti është i vlefshëm, për sa i përket formës, nëse ai plotëson kriteret e vlefshmërisë, sipas njërit prej ligjeve të mëposhtme:

a) ligjit të shtetit, në të cilin trashëgimlënësi ka bërë testamentin;

b) ligjit të shtetit, shtetësinë e të cilit ka trashëgimlënësi në kohën e bërjes së testamentit ose në kohën e vdekjes së tij;

c) ligjit të shtetit, në të cilin trashëgimlënësi, në kohën e bërjes së testamentit ose në kohën e vdekjes së tij, ka pasur vendqëndrimin e zakonshëm;

ç) ligjit të shtetit, në të cilin ndodhet pasuria e paluajtshme e disponuar në testament.

2. Rregullat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni zbatohen edhe për ndryshimin ose revokimin e testamentit.

KREU VI
PRONËSIA

SEKSIONI I
Të drejtat reale

Neni 36
Pronësia, posedimi dhe të drejtat reale mbi sendin

1. Pronësia, posedimi dhe të drejtat e tjera reale mbi sende të luajtshme dhe të paluajtshme rregullohen nga ligji i shtetit në të cilin ndodhet sendi.

2. Fitimi apo humbja e pronësisë, posedimit dhe e të drejtave reale rregullohen nga ligji i shtetit, në territorin e të cilit ndodhet sendi në kohën e verifikimit të rrethanave faktike, që përcaktojnë fitimin ose humbjen e këtyre të drejtave.

3. Përcaktimi nëse një send është i luajtshëm apo i paluajtshëm bëhet sipas ligjit të shtetit ku ndodhet sendi.

Neni 37
Letrat me vlerë

1. Të drejtat mbi titujt e regjistrueshëm dhe të negociueshëm rregullohen nga ligji i shtetit në të cilin ndodhet regjistri.

2. Fitimi dhe humbja e këtyre të drejtave rregullohen nga ligji i shtetit në të cilin ndodhet letra me vlerë, në kohën e kryerjes së aktit, mbi të cilin bazohet fitimi apo humbja e së drejtës.

Neni 38
Të drejtat e fituara

Në rast të ndryshimit të vendndodhjes së sendit, të drejtat e fituara, sipas ligjit të shtetit ku gjendej sendi, nuk mund të ushtrohen në kundërshtim me ligjin e shtetit të vendndodhjes së re të tij.

Neni 39
Sendet në transit

Të drejtat reale mbi një send në transit rregullohen nga ligji i shtetit të destinacionit.

Neni 40
Mbrojtja e trashëgimisë kulturore

1. Kur sendet, që përfshihen në trashëgiminë kulturore të një shteti, dalin jashtë territorit të tij në mënyrë të paligjshme, rivendikimi i tyre rregullohet nga ligji i shtetit nga ku ka dalë sendi, në fuqi në kohën e daljes së sendit. Shteti, nga i cili ka dalë sendi, mund të zgjedhë të zbatojë ligjin e shtetit, në territorin e të cilit gjendet sendi në kohën e rivendikimit të tij.

2. Megjithatë, nëse ligji i shtetit, ku sendi përfshihet në trashëgiminë e tij, nuk merr parasysh mbrojtjen e poseduesit në mirëbesim, ky i fundit mund të kërkojë mbrojtjen që i siguron ligji i shtetit, në territorin e të cilit gjendet sendi në kohën e rivendikimit të tij.

Neni 41
Mjetet e transportit

Të drejtat mbi mjetet e fluturimit, anijet dhe mbi të gjitha mjetet e tjera të transportit, të regjistruara në një regjistër publik, rregullohen nga ligji i shtetit, në territorin e të cilit janë regjistruar.

SEKSIONI II
Të drejtat mbi pronësinë intelektuale

Neni 42
Territorialiteti i të drejtave mbi pronësinë intelektuale

1. Ekzistenca, vlefshmëria, objekti, pronësia, transferueshmëria, kohëzgjatja dhe shkelja e së drejtës së autorit, e të drejtave që lidhen me të dhe e të drejtave të tjera intelektuale të paregjistruara rregullohen nga ligji i shtetit, për të cilin kërkohet mbrojtja.

2. Ekzistenca, vlefshmëria, objekti, pronësia, transferueshmëria, kohëzgjatja dhe shkelja e të drejtave industriale të regjistruara rregullohen nga ligji i vendit, që ka dhënë ose regjistruar të drejtën.

Neni 43
Të drejtat e pronësisë intelektuale, të krijuara gjatë marrëdhënieve të punës

E drejta e pronësisë intelektuale, që rrjedh nga një marrëdhënie pune, rregullohet nga ligji që rregullon kontratën e punës.

Neni 44
Kontratat që kanë të bëjnë me të drejtat e pronësisë intelektuale

Për kontratat, që kanë të bëjnë me të drejtat e pronësisë intelektuale, zbatohen rregullat e parashikuara në kreun VII të këtij ligji.

KREU VII
DETYRIMET DHE KONTRATAT

Neni 45
Liria e zgjedhjes së ligjit të zbatueshëm

1. Kontrata rregullohet nga ligji i zgjedhur nga palët. Me vullnetin e tyre, palët mund të zgjedhin ligjin e zbatueshëm për të gjithë ose për një pjesë të veçantë të kontratës. Nëse palët kanë caktuar juridiksionin për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që rrjedhin nga kontrata, prezumohet se kanë zgjedhur ligjin e atij shteti për rregullimin e kontratës.

2. Zgjedhja e ligjit duhet të jetë e shprehur ose të rezultojë e qartë nga kushtet e kontratës ose rrethana të tjera të çështjes.

3. Palët mund të bien në çdo kohë dakord që kontrata të rregullohet nga një ligj tjetër, i ndryshëm nga ai që ishte përcaktuar në fillim në kontratë. Çdo ndryshim i mëvonshëm i ligjit të zbatueshëm, pas lidhjes së kontratës, nuk cenon vlefshmërinë formale të kontratës apo të drejtat e të tretëve.

4. Kur të gjitha elementet e tjera të rëndësishme të situatës në kohën e zgjedhjes së ligjit ndodhen në një vend tjetër, zgjedhja e ligjit nga palët nuk cenon zbatimin e dispozitave të ligjit të shtetit tjetër, të cilat nuk mund të shmangen nga marrëveshja.

5. Ekzistenca dhe vlefshmëria e kontratës apo e njërit prej kushteve të saj rregullohen nga ligji i zbatueshëm për kontratën.

Neni 46
Ligji i zbatueshëm në mungesë të zgjedhjes

1. Në masën që ligji i zbatueshëm për kontratën nuk është zgjedhur në pajtim me nenin 45 të këtij ligji, ligji që rregullon kontratën përcaktohet si më poshtë:

a) një kontratë shitjeje rregullohet nga ligji i vendit ku shitësi ka vendqëndrimin e tij të zakonshëm;

b) një kontratë për furnizimin e shërbimeve rregullohet nga ligji i vendit ku ofruesi i shërbimit ka vendqëndrimin e tij të zakonshëm;

c) një kontratë në lidhje me të drejtat reale mbi pasurinë e paluajtshme apo të drejtën e përdoruesit të një pasurie të paluajtshme rregullohet nga ligji i vendit ku ndodhet pasuria;

ç) pavarësisht nga shkronja "c" e kësaj pike, një kontratë qiraje e lidhur për përdorim individual të përkohshëm të një pasurie të paluajtshme, për një periudhë prej jo më shumë se gjashtë muajsh të njëpasnjëshëm, rregullohet nga ligji i shtetit ku qiradhënësi ka vendbanimin e tij të zakonshëm, me kusht që qiramarrësi të jetë person fizik dhe të ketë vendqëndrimin e tij të zakonshëm në të njëjtin shtet;

d) një kontratë franshizingu rregullohet nga ligji i shtetit ku franshizingmarrësi ka vendqëndrimin e tij të zakonshëm;

dh) një kontratë për furnizimin e mallrave rregullohet nga ligji i shtetit ku furnizuesi ka vendqëndrimin e tij të zakonshëm;

e) një kontratë për shitjen e mallrave me ankand rregullohet nga ligji i shtetit ku zhvillohet ankandi, nëse ky shtet mund të përcaktohet;

ë) një kontratë e lidhur brenda një sistemi shumëpalësh, që bashkon ose lehtëson bashkimin e shumë palëve të treta, që blejnë dhe shesin interesa në instrumentet financiare, në përputhje me rregullat e legjislacionit përkatës, dhe e rregulluar nga një ligj i vetëm, rregullohet nga ai ligj.

2. Kontratat, të cilat nuk janë përmendur shprehimisht në pikën 1 të këtij neni, ose kur elementet e kontratës përfshijnë tiparet e më shumë se një nga llojet e kontratave të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, kontrata rregullohet nga ligji i shtetit, ku pala që duhet të përmbushë shërbimin që karakterizon kontratën ka vendbanimin e saj të zakonshëm në çastin e lidhjes së kontratës.

3. Kur është e qartë nga të gjitha rrethanat e çështjes se kontrata është haptazi e lidhur më ngushtë me një shtet të ndryshëm nga ai i përcaktuar në pikën 1 ose 2 të këtij neni, zbatohet ligji i atij shteti.

4. Kur ligji i zbatueshëm nuk mund të përcaktohet sipas pikës 1 ose 2 të këtij neni, kontrata rregullohet nga ligji i shtetit, me të cilin ka lidhje më të ngushtë.

Neni 47

Fusha e zbatimit të ligjit, i cili rregullon kontratat

1. Ligji i zbatueshëm për kontratat rregullon veçanërisht:

a) interpretimin e saj;

b) përmbushjen e detyrimeve, që rrjedhin nga kontratat;

c) brenda kompetencave të dhëna gjykatës nga ligji procedural, pasojat e mospërmbushjes së plotë ose të pjesshme të këtyre detyrimeve, përfshirë edhe vlerësimin e dëmit, për sa kohë që këto rrjedhin nga dispozitat ligjore dhe nuk i kapërcejnë kufijtë e përcaktuar nga ligji shqiptar;

ç) mënyrat e ndryshme të shuarjes së detyrimeve, si dhe parashkrimin e padisë dhe dekadencën;

d) pasojat e pavlefshmërisë së kontratave.

2. Mënyra e përmbushjes së detyrimit, si dhe masat që duhet të marrë kreditori në rastet e mospërmbushjes si duhet të detyrimeve rregullohen nga ligji i shtetit ku përmbushet detyrimi.

Neni 48

Kontrata e punës

1. Kontrata individuale e punës rregullohet nga ligji i zgjedhur nga palët.

2. Kur palët nuk kanë zgjedhur ligjin e zbatueshëm, ndiqen rregullat e parashikuara në nenin 3 të Kodit të Punës.

Neni 49

Kalimi i kredisë dhe zëvendësimi kontraktual

1. Kalimi i kredisë nga njëri kreditor te tjetri apo zëvendësimi i debitorit me një tjetër rregullohet nga ligji i shtetit, i cili rregullon kontratën e tyre.

2. Ligji i zbatueshëm përcakton nëse kredia mund të kalohet, marrëdhëniet ndërmjet kreditorit të ri ose të zëvendësuarit dhe debitorit, kushtet e kundrejtimit të kalimit të kredisë apo zëvendësimit ndaj debitorit, si dhe shkarkimin nga detyrimi të debitorit.

3. Kalimi i kredisë, sipas këtij neni, përfshin transferimet e plota të kredive, transferimin e kredive në formë garancie ose të të drejtave të tjera të garancisë mbi kreditë.

Neni 50

Kontrata e transportit

1. Palët mund të zgjedhin si ligj të zbatueshëm të kontratës së transportit të udhëtarëve vetëm ligjin e shtetit ku:

a) udhëtari ka vendqëndrimin e tij të zakonshëm;

b) transportuesi ka vendqëndrimin e tij të zakonshëm;

c) transportuesi ka vendin e selisë qendrore;

ç) ndodhet vendi i nisjes;

d) ndodhet vendi i destinacionit.

2. Kur ligji i zbatueshëm për një kontratë transporti të udhëtarëve nuk është zgjedhur nga palët, zbatohet ligji i shtetit ku pasagjeri ka vendqëndrimin e zakonshëm, me kusht që edhe vendi i nisjes dhe vendi i destinacionit ndodhen, gjithashtu, në këtë shtet. Kur nuk plotësohet ky kusht, zbatohet ligji i shtetit ku transportuesi ka vendqëndrimin e zakonshëm.

3. Kur ligji i zbatueshëm për një kontratë transporti të mallrave nuk është zgjedhur nga palët, zbatohet ligji i shtetit ku transportuesi ka vendqëndrimin e zakonshëm, me kusht që vendi i marrjes apo dorëzimit ose vendqëndrimi i zakonshëm i dorëzuesit ndodhet, gjithashtu, në këtë shtet.

4. Kur rezulton e qartë nga të gjitha rrethanat e çështjes se kontrata, në mungesë të zgjedhjes së ligjit nga palët, është dukshëm e lidhur ngushtë me një shtet të ndryshëm nga ai i treguar në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni, zbatohet ligji i këtij shteti.

Neni 51

Kontrata e sigurimit

1. Ligji i zbatueshëm për kontratën e sigurimit, që mbulon një rrezik të madh, është ligji i zgjedhur nga palët.

2. Kur ligji i zbatueshëm nuk është zgjedhur nga palët, kontrata e sigurimit, që mbulon një rrezik të madh, rregullohet nga ligji i shtetit ku siguruesi ka vendqëndrimin e zakonshëm.

3. Kur është e qartë nga të gjitha rrethanat e çështjes se kontrata është dukshëm e lidhur ngushtë me një shtet tjetër, zbatohet ligji i këtij shteti.

4. Në rastin e kontratave të tjera të sigurimit, të ndryshme nga kontrata e sigurimit, që mbulon një rrezik të madh, palët mund të zgjedhin:

a) ligjin e shtetit ku ndodhet rreziku në kohën e lidhjes së kontratës;

b) ligjin e shtetit ku mbajtësi i policës së sigurimit ka vendqëndrimin e zakonshëm;

c) ligjin e shtetit, shtetas i të cilit është mbajtësi i policës së sigurimit në rastin e sigurimit të jetës;

ç) ligjin e shtetit përkatës ose ligjin në fuqi në vendqëndrimin e zakonshëm të mbajtësit të policës, kur mbajtësi i policës së sigurimit të një kontrate kryen një veprimtari ekonomike dhe kontrata e sigurimit mbulon dy apo më shumë rreziqe, të cilat lidhen me këto veprimtari dhe ndodhen në shtete të ndryshme.

5. Kur ligji zbatueshëm nuk është zgjedhur nga palët, kontrata e sigurimit, sipas pikës 4 të këtij neni, rregullohet nga ligji i shtetit ku ndodhet rreziku në kohën e lidhjes së kontratës.

6. Rregullat e kësaj dispozite nuk zbatohen për kontratat e risigurimit.

Neni 52

Kontratat me konsumatorin

1. Pa cenuar nenet 50 dhe 51 të këtij ligji, kontrata e lidhur ndërmjet një konsumatori dhe një personi, që vepron në ushtrim të veprimtarisë së tij tregtare apo profesionale, rregullohet nga ligji i shtetit, në të cilin konsumatori ka vendqëndrimin e zakonshëm, me kusht që:

a) tregtari ose profesionisti:

i) të zhvillojë veprimtarinë e tij tregtare apo profesionale në shtetin e vendqëndrimit të konsumatorit;

ii) të drejtojë këto veprimtari, me çfarëdo mjeti, drejt këtij shteti apo në shtete të ndryshme, ku përfshihet edhe ky i fundit;

b) kontrata të hyjë në sferën e këtyre veprimtarive.

2. Përjashtimisht nga pika 1 e këtij neni, palët mund të zgjedhin ligjin e zbatueshëm të kontratës, që plotëson kushtet e pikës 1, në përputhje me nenin 45 të këtij ligji. Megjithatë, zgjedhja

e ligjit nuk mund të privojë konsumatorin nga mbrojtja, që i sigurohet nga dispozitat, të cilat nuk mund të shmangen me marrëveshje, sipas ligjit që, në mungesë të zgjedhjes, zbatoheshin në bazë të pikës 1.

3. Nëse nuk plotësohen kushtet, sipas shkronjës "a" të pikës 1 të këtij neni, ligji i zbatueshëm në kontratën ndërmjet konsumatorit dhe profesionistit përcaktohet sipas neneve 45 dhe 46 të këtij ligji.

4. Pikat 1 e 2 të këtij neni nuk zbatohen për:

a) kontratat për furnizimin e shërbimeve, ku shërbimet duhet të furnizohen te konsumatori ekskluzivisht në një shtet tjetër nga ai në të cilin konsumatori ka vendqëndrimin e tij të zakonshëm;

b) kontratat e transportit, të ndryshme nga kontratat që kanë të bëjnë me paketë udhëtimi;

c) kontratat, që kanë të bëjnë me një të drejtë reale ose të drejtë përdoruesi në pasurinë e paluajtshme, të ndryshme nga kontratat që kanë të bëjnë me të drejtën për të përdorur pronën me kohë të pjesshme;

ç) të drejtat dhe detyrimet, të cilat përbëjnë një instrument financiar, apo kushtet për emetimin ose ofrimin për publikun, dhe ofertat për blerjen e letrave me vlerë të transferueshme, si dhe blerje e njësive në sipërmarrjet kolektive, për sa kohë që këto veprimtari nuk përbëjnë furnizim të një shërbimi financiar;

d) një kontratë të lidhur në llojin e sistemit, sipas përcaktimeve në shkronjën "ë" të pikës 1 të nenit 46 të këtij ligji.

Neni 53

Zëvendësimi ligjor

Kur, në bazë të një detyrimi kontraktor, kreditori ka një të drejtë ndaj debitorit dhe një person i tretë detyrohet të shlyejë kreditorin ose e ka shlyer atë në përmbushje të këtij detyrimi, ligji, që rregullon detyrimin e personit të tretë për të shlyer kreditorin, zbatohet edhe për përcaktimin e masës dhe të shkakut pse personi i tretë ka të drejtë të ushtrojë kundër debitorit të drejtat që kreditori kishte kundër debitorit, sipas ligjit që rregullon marrëdhëniet e tyre.

Neni 54

Detyrimet solidare

Nëse kreditori ka të drejtën e një kredie kundër disa debitorëve solidarë dhe një prej tyre ka përmbushur detyrimin, tërësisht ose pjesërisht, ligji, që rregullon detyrimin e këtij debitori ndaj kreditorit, rregullon edhe të drejtën e debitorit për të kërkuar përmbushjen e detyrimit nga debitorët e tjerë. Debitorët e tjerë mund të kundrejtojnë prapësimet, që mund t'i kundrejtonin kreditorit, në masën e lejuar nga ligji që rregullon detyrimin e tyre ndaj kreditorit.

Neni 55

Kompensimi ligjor

Kur palët nuk kanë rënë dakord për të drejtën e kompensimit, kjo e drejtë rregullohet nga ligji i zbatueshëm ndaj kredisë, për të cilën kërkohet e drejta e kompensimit.

KREU VIII
DETYRIMET JASHTËKONTRAKTORE

SEKSIONI I
Rregulla të përgjithshme

Neni 56
Dëmet jashtëkontraktore

1. Ligji i aplikueshëm për një detyrim jashtëkontraktor është ligji i shtetit, në të cilin ndodhi dëmi, pavarësisht nga shteti, në të cilin ngjarja që shkaktoi dëmin ndodhi dhe pavarësisht nga shteti apo shtetet në të cilin/cilat ndodhin pasojat indirekte, përveç kur nuk parashikohet ndryshe në dispozitat e këtij kreu.

2. Pavarësisht nga pika 1 e këtij neni, kur personi përgjegjës për dëmin dhe personi që ka pësuar dëmin kanë vendqëndrimin e tyre të përbashkët në të njëjtin shtet, në kohën kur ndodhi ngjarja, zbatohet ligji i këtij shteti.

3. Kur është e qartë nga të gjitha rrethanat e çështjes se dëmi jashtëkontraktor është dukshëm i lidhur më ngushtë me një vend të ndryshëm nga ai që tregohet në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, zbatohet ligji i këtij shteti.

4. Lidhja dukshëm më e ngushtë me një shtet tjetër mund të bazohet në veçanti në marrëdhëniet e mëparshme ndërmjet palëve, të tilla si kontrata, e cila është dukshëm e lidhur ngushtë me dëmin jashtëkontraktor.

Neni 57
Liria e zgjedhjes së ligjit të zbatueshëm për detyrime jashtëkontraktore

1. Palët mund të zgjedhin ligjin e zbatueshëm për një detyrim jashtëkontraktor, pavarësisht nga përcaktimet e dispozitave të këtij kreu:

a) me marrëveshje të lidhur pas ngjarjes që ka shkaktuar dëmin;

b) me marrëveshje të lidhur lirisht, përpara ngjarjes që ka shkaktuar dëmin, kur të gjitha palët ndjekin një veprimtari tregtare.

2. Zgjedhja e ligjit duhet të shprehet ose të shfaqet me siguri të arsyeshme nga të gjitha rrethanat e çështjes dhe nuk duhet të cenojë të drejtat e palëve të treta.

3. Kur të gjitha elementet, që kanë të bëjnë me situatën në kohën e verifikimit të ngjarjes, që ka shkaktuar dëmin, ndodhen në një shtet tjetër nga shteti, ligjin e të cilit kanë zgjedhur palët, zgjedhja e ligjit nga palët nuk cenon zbatimin e dispozitave të ligjit të këtij shteti, të cilat nuk mund të shmangen me marrëveshje të palëve.

Neni 58
Fusha e ligjit të zbatueshëm

Ligji i zbatueshëm për detyrimet jashtëkontraktore rregullon në veçanti:

a) bazën dhe shkallën e përgjegjësisë, përfshirë edhe përcaktimin e personave, të cilët mund të konsiderohen përgjegjës për aktet e kryera prej tyre;

b) shkaqet për përjashtimin, kufizimin dhe ndarjen e përgjegjësisë;

c) ekzistencën, natyrën dhe vlerësimin e dëmit ose dëmshpërblimin e pretenduar;

ç) masat që gjykata mund të marrë për të parandaluar, për të pushuar ose për të kompensuar dëmin, brenda kufijve të kompetencave të gjykatës, sipas ligjit të saj procedural;

d) çështjen nëse e drejta për të kërkuar dëmet ose dëmshpërblimin mund të transferohet, përfshirë edhe me trashëgimi;

dh) personat që kanë të drejtë për kompensimin e dëmit të pësuar personalisht;

e) përgjegjësinë për aktet e një personi tjetër;

ë) mënyrën, në të cilën një detyrim mund të shuhet dhe rregullat e parashkrimit, përfshirë rregullat për fillimin, ndërprerjen e pezullimin e parashkrimit dhe dekadencën.

Neni 59
Rregullat e sigurisë dhe sjelljes

Në vlerësimin e sjelljes së personit, që pretendohet përgjegjës, mbahen në konsideratë, si çështjet e faktit dhe kur është e përshtatshme, rregullat e sigurisë dhe të sjelljes në fuqi në vendin dhe kohën e ngjarjes që passjell përgjegjësinë.

Neni 60
Veprimi i drejtpërdrejtë kundër siguruesit të personit përgjegjës

Pala e dëmtuar mund të kërkojë dëmshpërblim për dëmet e pësuara drejtpërdrejt nga siguruesi i personit të detyruar për dëmshpërblim, nëse parashikohet nga ligji i zbatueshëm ndaj detyrimit jashtëkontraktor ose ligji i zbatueshëm i kontratës së sigurimit.

Neni 61
Zëvendësimi

Kur, në bazë të një detyrimi jashtëkontraktor, kreditori ka një të drejtë ndaj debitorit dhe një person i tretë detyrohet të shlyejë kreditorin ose e ka shlyer atë në përmbushje të këtij detyrimi, ligji, që rregullon detyrimin e personit të tretë për të shlyer kreditorin, zbatohet edhe për përcaktimin e masës e të shkakut pse personi i tretë ka të drejtë të ushtrojë kundër debitorit të drejtat që kreditori kishte kundër debitorit, sipas ligjit që rregullon marrëdhëniet e tyre.

Neni 62
Detyrimet solidare

Nëse kreditori ka të drejtë të kërkojë përmbushjen e të njëjtit detyrim nga disa debitorë solidarë dhe njëri prej tyre ka përmbushur detyrimin, tërësisht ose pjesërisht, e drejta e debitorit për të kërkuar pagimin nga debitorët e tjerë të detyrimit të përmbushur rregullohet nga ligji i zbatueshëm për detyrimin jashtëkontraktor të këtij debitori ndaj kreditorit.

SEKSIONI II
Rregulla të veçanta

Neni 63
Përgjegjësia nga produktet

1. Përgjegjësia për dëmin që rrjedh nga produktet rregullohet me radhë nga:

a) ligjit i shtetit, në të cilin personi që ka pësuar dëmin ka vendqëndrimin e tij të zakonshëm në kohën kur është shkaktuar dëmi, nëse produkti ishte hedhur në treg në atë shtet;

b) ligji i shtetit, në të cilin produkti u ble, nëse produkti ishte hedhur në treg në atë shtet;

c) ligji i shtetit, në të cilin u shkaktua dëmi, nëse produkti ishte hedhur në treg në atë shtet.

2. Nëse personi, që pretendohet se është përgjegjës, nuk mund të parashikonte në mënyrë të arsyeshme hedhjen në treg të produktit ose të një produkti të të njëjtit lloj, zbatohet ligji i shtetit ku ai ka vendqëndrimin e tij të zakonshëm.

3. Kur është e qartë nga të gjitha rrethanat e çështjes se dëmi jashtëkontraktor është dukshëm i lidhur më ngushtë me një shtet tjetër nga ai që tregohet në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, zbatohet ligji i këtij shteti.

Neni 64

Konkurrenca e padrejtë dhe veprimet që kufizojnë konkurrencën e lirë

1. Ligji i zbatueshëm për një detyrim jashtëkontraktor, që rrjedh nga një veprim që përbën konkurrencë të padrejtë, është ligji i shtetit ku marrëdhëniet konkurruese apo të interesave kolektivë të konsumatorëve janë ose mund të jenë prekur.

2. Pavarësisht nga pika 1 e këtij neni, kur personi që pretendohet përgjegjës për konkurrencën e pandershme dhe personi që ka pësuar dëmin kanë vendqëndrimin e tyre të zakonshëm në të njëjtin shtet, kur ka ndodhur ngjarja, zbatohet ligji i atij shteti.

3. Kur një veprim i konkurrencës së pandershme prek në mënyrë ekskluzive interesat e një konkurruesi specifik, zbatohet ligji i shtetit, në të cilin ka ndodhur dëmi, pavarësisht nga shteti në të cilin ka ndodhur ngjarja që ka shkaktuar dëmin apo pavarësisht nga shteti ose shtetet, në të cilin/cilat kanë ndodhur pasojat indirekte të ngjarjes.

4. Ligji i zbatueshëm për një detyrim jashtëkontraktor, që rrjedh nga një kufizim i konkurrencës, është ligji i shtetit ku tregu është ose mund të jetë prekur.

5. Kur tregu është prekur ose ka të ngjarë të jetë prekur në më shumë se një shtet, personi, i cili kërkon kompensim për dëmin dhe bën padi në gjykatën e vendbanimit të të padituri, në vend të kësaj mund të zgjedhë që kërkesa e tij të bazohet në zbatimin e ligjit të gjykatës në shtetin tjetër, me kusht që tregu në atë shtet është mes atyre që drejtpërdrejt dhe në thelb janë të prekura nga kufizimi i konkurrencës, nga e cila ka lindur detyrimi dhe është bazuar kërkesa për detyrimin jokontraktual.

6. Kur paditësi padit, në përputhje me rregullat e zbatueshme të juridiksionit, më shumë se një të paditur në atë gjykatë, paditësi mund të zgjedhë të bazojë kërkesën e tij në ligjin e kësaj gjykate, vetëm nëse kufizimi i konkurrencës, për të cilën kërkesa kundër secilit prej këtyre të padituve mbështetet drejtpërdrejt dhe ndikon në thelb edhe tregun e shtetit të kësaj gjykate.

7. Ligji i zbatueshëm, sipas këtij neni, nuk mund të shmanget me marrëveshje, sipas nenit 57 të këtij ligji.

Neni 65

Shkelja e të drejtave të pronësisë intelektuale

1. Ligji i zbatueshëm për detyrimet jashtëkontraktore, që rrjedhin nga shkelja e të drejtave të pronësisë intelektuale, është ligji i shtetit, për të cilin është kërkuar mbrojtja.

2. Ligji i zbatueshëm nuk mund të shmanget nga marrëveshja e palëve për zgjedhjen e ligjit, që rregullon detyrimet jashtëkontraktore që rrjedhin nga shkelja e pronësisë intelektuale.

Neni 66

Dëmi mjedisor

1. Ligji i zbatueshëm për një detyrim jashtëkontraktor, që rrjedh nga dëmi mjedisor ose dëmi i pësuar nga persona apo prona, si rezultat i këtij dëmi, është ligji i vendit, ku ka ndodhur dëmi, pavarësisht nga vendi në të cilin ndodhi ngjarja dhe pavarësisht nga vendi ose vendet në të cilin/cilat pasojat indirekte të kësaj ngjarjeje ndodhën.

2. Pavarësisht nga pika 1 e këtij neni, personi që kërkon kompensim për dëmet zgjedh që ta bazojë kërkesën e tij në ligjin e vendit, në të cilin ndodhi ngjarja që shkaktoi dëmin.

Neni 67

Cenimi i të drejtave morale

1. Dëmet jashtëkontraktore, që rrjedhin nga cenimi i të drejtave të personalitetit, sipas zgjedhjes së personit të dëmtuar, rregullohen nga:

a) ligji i shtetit, ku ai ka vendbanimin e zakonshëm;

b) ligji i shtetit, në territorin e të cilit ka ndodhur dëmi moral;

c) ligji i shtetit, ku gjendet vendqëndrimi i zakonshëm i personit përgjegjës për dëmin.

2. Rastet e shkronjave “a” dhe “b” të pikës 1 të këtij neni zbatohen nëse personi përgjegjës duhej të kishte parashikuar në mënyrë të arsyeshme se dëmi ndodhte në territorin e këtij shteti.

Neni 68
Begatimi pa shkak dhe pagimi i padetyruar

1. Detyrimi jashtëkontraktor, që rrjedh nga begatimi pa shkak apo pagimi i padetyruar, që lidhet me një marrëdhënie ekzistuese ndërmjet palëve, të tilla si kontrata apo dëme jashtëkontraktore, që kanë lidhje të ngushtë me atë begatimin pa shkak apo pagimin e padetyruar, rregullohet nga ligji që zbatohet për atë marrëdhënie.

2. Kur ligji i zbatueshëm nuk mund të përcaktohet sipas pikës 1 të këtij neni dhe palët kanë vendqëndrimin e zakonshëm në të njëjtin shtet ku ndodhi ngjarja, nga e cila rrjedh begatimi pa shkak apo pagimi i padetyruar, zbatohet ligji i këtij shteti.

3. Kur ligji i zbatueshëm nuk mund të përcaktohet, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, zbatohet ligji i shtetit ku ndodhi begatimi pa shkak apo pagimi i padetyruar.

4. Kur është e qartë nga të gjitha rrethanat e çështjes se detyrimi, që rrjedh nga begatimi pa shkak apo pagimi i padetyruar është dukshëm i lidhur ngushtë me një shtet tjetër nga ai që tregohet në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni, zbatohet ligji i këtij shteti.

Neni 69
Gjerimi i punëve të të tjerëve

1. Detyrimi jashtëkontraktor, që rrjedh nga gjerimi i punëve të të tjerëve, që lidhet me një marrëdhënie që ekziston ndërmjet palëve, të tilla si kontrata apo dëme jashtëkontraktore, që kanë lidhje të ngushtë me gjerimin e punëve të të tjerëve, rregullohet nga ligji që zbatohet për atë marrëdhënie.

2. Kur ligji i zbatueshëm nuk mund të përcaktohet sipas pikës 1 të këtij neni dhe palët kanë vendqëndrimin e zakonshëm në të njëjtin shtet ku ndodhi ngjarja, nga e cila rrjedh dëmi, zbatohet ligji i këtij shteti.

3. Kur ligji i zbatueshëm nuk mund të përcaktohet sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, zbatohet ligji i shtetit ku u krye veprimi.

4. Kur është e qartë nga të gjitha rrethanat e çështjes se detyrimi që rrjedh nga gjerimi është dukshëm i lidhur më ngushtë me një shtet tjetër nga ai që tregohet në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni, zbatohet ligji i këtij shteti.

Neni 70
Përgjegjësia parakontraktore

1. Ligji i zbatueshëm për detyrimet jashtëkontraktore, që rrjedhin nga marrëveshjet para lidhjes së kontratës, pavarësisht nga fakti i lidhjes ose jo të kontratës, është ligji që zbatohet për kontratën ose që do të zbatohej në rast se ajo do të ishte lidhur.

2. Kur ligji i zbatueshëm nuk mund të përcaktohet sipas pikës 1 të këtij neni, zbatohet:

a) ligji i shtetit, në të cilin ndodhi dëmi, pavarësisht nga shteti, në të cilin ngjarja që shkaktoi dëmin ndodhi apo nga shteti ose shtetet, në të cilin/cilat pasojat indirekte të kësaj ngjarjeje ndodhën;

b) ligji i shtetit ku palët kanë vendqëndrimin e tyre të zakonshëm, nëse është i njëjtë me shtetin ku ndodhi ngjarja, nga e cila rrjedh dëmi.

3. Kur është e qartë nga të gjitha rrethanat e çështjes se detyrimi që rrjedh nga bisedimet para lidhjes së kontratës është dukshëm i lidhur më ngushtë me një shtet tjetër nga ai që parashikohet në pikën 2 të këtij neni, zbatohet ligji i këtij shteti.

KREU IX
JURIDIKSIONI I GJYKATAVE SHQIPTARE NË SHQYRTIMIN E ÇËSHTJEVE ME ELEMENTE TË HUAJA

Neni 71
Rregulli i përgjithshëm i juridiksionit ndërkombëtar

Gjykatat shqiptare kanë juridiksion në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve juridiko-civile me elemente të huaja, nëse pala e paditur ka vendqëndrimin e zakonshëm në Republikën e Shqipërisë, përveçse kur rregullat e këtij kreu parashikojnë ndryshe.

Neni 72
Juridiksioni ekskluziv

Pavarësisht nga rregullat e këtij ligji, gjykatat shqiptare kanë juridiksion ekskluziv në çdo rast për gjykimin e:

a) çështjeve me objekt të drejtën e pronësisë dhe të drejta të tjera reale mbi sende të paluajtshme, si dhe qiranë dhe të drejtat që rrjedhin nga përdorimi i pasurive të paluajtshme kundrejt shpërblimit, kur këto ndodhen në Republikën e Shqipërisë;

b) çështjeve me objekt vendimet e organeve të shoqërive tregtare, kur shoqëria ka vendqëndrimin e zakonshëm në Republikën e Shqipërisë;

c) çështjeve me objekt themelimin, mbarimin e personave juridikë, si dhe paditë me objekt vendimet e organeve të tyre, kur personi juridik ka selinë në Republikën e Shqipërisë;

ç) çështjeve me objekt vlefshmërinë e regjistrimit në regjistrat e gjykatave ose organeve shtetërore shqiptare;

d) çështjeve me objekt vlefshmërinë e regjistrimit të të drejtave intelektuale, për sa kohë që këto regjistrime ose kërkesa për këto regjistrime është bërë në Republikën e Shqipërisë;

dh) çështjeve, të cilat lidhen me ekzekutimin në Republikën e Shqipërisë të titujve ekzekutivë.

Neni 73
Juridiksioni i caktuar me marrëveshje

1. Gjykatat shqiptare kanë juridiksion ndërkombëtar edhe kur palët caktojnë me marrëveshje juridiksionin ndërkombëtar të gjykatave shqiptare.

2. Një marrëveshje e tillë duhet:

a) të lidhet me shkrim ose me gojë, por duke u vërtetuar kjo e fundit me shkrim;

b) të jetë në përputhje me zakonet tregtare ndërkombëtare, të cilat janë ose konsiderohen të njohura nga palët.

3. Gjykata shqiptare, në të cilën është ngritur padia, ka juridiksion ndërkombëtar, nëse i padituri merr pjesë në gjykim pa ngritur pretendime për mungesën e juridiksionit ndërkombëtar, megjithëse është i përfaqësuar në proces nga një avokat, ose gjykata e ka sqaruar për mundësinë e kundërshtimit të juridiksionit dhe ky sqarim është shënuar në procesverbalin e seancës gjyqësore.

Neni 74
Juridiksioni për shpalljen e zhdukjes dhe të vdekjes së një personi

Gjykatat shqiptare kanë juridiksion për shpalljen e një personi të zhdukur ose të vdekur kur:

a) personi, i cili shpallet i zhdukur ose i vdekur, ka pasur shtetësinë shqiptare në kohën e zhdukjes ose të vdekjes;

b) personi, i cili shpallet i zhdukur ose i vdekur, ka pasur vendqëndrimin e fundit në Republikën e Shqipërisë;

c) personi, i cili paraqet kërkesën, ka një interes të ligjshëm në shpalljen e zhdukjes ose të vdekjes së një personi nga një gjykatë shqiptare.

Neni 75

Juridiksioni për martesën

1. Gjykatat shqiptare kanë juridiksion në gjykimin e çështjeve që lidhen me martesën kur:

a) njëri nga bashkëshortët është ose ka qenë në kohën e lidhjes së martesës shtetas shqiptar;

b) bashkëshorti, kundër të cilit është ngritur padia, apo paditësi, në rastin për zgjidhjen e martesës, ka vendqëndrimin e tij të zakonshëm në Republikën e Shqipërisë;

c) njëri nga bashkëshortët është pa shtetësi dhe ka vendqëndrimin e tij të zakonshëm në Republikën e Shqipërisë.

2. Paditë, që lidhen me martesën, sipas pikës 1 të këtij neni, janë paditë për zgjidhjen dhe shpalljen e pavlefshmërisë së martesës, vërtetimin e lidhjes së martesës, si dhe ato që lidhen me regjimet pasurore martesore.

3. Juridiksioni, sipas pikës 1 të këtij neni, shtrihet edhe mbi pasojat, që vijnë nga zgjidhja, shpallja e pavlefshmërisë së martesës, nga regjimet pasurore martesore, si dhe mbi masat e përkohshme, të cilat merren nga gjykata në këto raste.

Neni 76

Juridiksioni për marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve, prindërve dhe fëmijëve, atësia, amësia

Gjykatat shqiptare kanë juridiksion të gjykojnë çështjet, që lidhen me të drejtat dhe detyrimet, që rrjedhin nga martesa midis prindërve dhe fëmijëve, njohjen apo kundërshtimin e atësisë dhe të amësisë, kur njëra nga palët ka shtetësinë shqiptare ose ka vendqëndrimin e saj në Republikën e Shqipërisë.

Neni 77

Juridiksioni për birësimin

Gjykatat shqiptare kanë juridiksion në gjykimin e çështjeve, që lidhen me birësimin, nëse të paktën njëri nga birësuesit është shtetas shqiptar, si dhe kur fëmija që birësohet është shtetas shqiptar ose ka vendqëndrimin e tij të zakonshëm në Republikën e Shqipërisë.

Neni 78

Juridiksioni për heqjen ose kufizimin e zotësisë për të vepruar

Gjykatat shqiptare kanë juridiksion në gjykimin e çështjeve, që lidhen me heqjen ose kufizimin e zotësisë për të vepruar, kur personi, të cilit do t'i kufizohet ose do t'i hiqet ajo, është shtetas shqiptar ose ka vendqëndrimin e tij të zakonshëm në Republikën e Shqipërisë.

Neni 79

Juridiksioni për kujdestarinë

Gjykatat shqiptare kanë juridiksion në gjykimin e çështjeve, që lidhen me kujdestarinë, nëse i mituri ose personi, i cili vihet në kujdestari, është shtetas shqiptar ose ka vendqëndrimin e tij të zakonshëm në Republikën e Shqipërisë.

Neni 80
Raste të tjera të juridiksionit ndërkombëtar

Gjykatat shqiptare kanë juridiksion ndërkombëtar edhe në rastet e mëposhtme:

a) kur paditen njëkohësisht disa persona së bashku dhe njëri prej tyre ka vendqëndrimin e tij në Republikën e Shqipërisë, si dhe kur personi juridik i paditur ka selinë e tij në Republikën e Shqipërisë;

b) kur padia ka për objekt një kontratë ose pretendime që rrjedhin nga një kontratë dhe vendi, në të cilin është përmbushur ose duhej përmbushur detyrimi, ndodhet në Republikën e Shqipërisë;

c) nëse objekt i gjykimit janë pretendimet, që rrjedhin nga shkaktimi i dëmit dhe vendi, ku është kryer apo ka ndodhur veprimi që ka shkaktuar dëmin, është në Republikën e Shqipërisë;

ç) kur padia ka për objekt mosmarrëveshje, që rrjedhin nga veprimtaria e një dege ose filiali të një personi juridik, me seli në Republikën e Shqipërisë;

d) kur padia rrjedh nga detyrimi për ushqim që ka një person kundrejt një personi, i cili ka vendqëndrimin e tij të zakonshëm në Republikën e Shqipërisë;

dh) paditë, që burojnë nga trashëgimia ligjore dhe ajo testamentare kur:

i) trashëgimlënësi ka pasur vendqëndrimin e tij, në kohën e vdekjes, në Republikën e Shqipërisë;

ii) pasuria trashëgimore ose pjesa më e madhe e saj ndodhet në Republikën e Shqipërisë.

Neni 81
Juridiksioni për masat për sigurimin e padisë

Gjykatat shqiptare kanë juridiksion për masat për sigurimin e padisë, kur ato duhet të ekzekutohen në Republikën e Shqipërisë ose nëse gjykatat shqiptare kanë juridiksion ndërkombëtar për objektin e gjykimit.

KREU X
DISPOZITA PROCEDURALE

Neni 82
Parim i përgjithshëm

1. Gjykimi i çështjeve gjyqësore me elemente të huaja para gjykatave shqiptare bëhet sipas ligjit procedural shqiptar.

2. Subjektet e huaja, si dhe personi pa shtetësi gëzojnë në gjykimet civile, të cilat zhvillohen para gjykatave shqiptare, të njëjtat të drejta dhe garanci procedurale si subjektet shqiptare.

Neni 83
Shpenzimet gjyqësore

1. Nëse paditësi është person fizik ose person juridik i huaj apo është person pa shtetësi dhe nuk e ka vendqëndrimin a selinë e tij në Republikën e Shqipërisë, atëherë, me kërkesë të palës së paditur, gjykata vendos që pala paditëse, brenda një afati të përshtatshëm, të caktuar prej saj, të depozitojë si garanci për mbulimin e shpenzimeve gjyqësore një shumë të caktuar ose një send.

2. Pala e paditur nuk ka të drejtë të kërkojë vënien e garancisë nga pala paditëse kur:

a) ligji i shtetit, shtetësinë e të cilit ka paditësi, nuk kërkon vënien e garancisë për shtetasit ose personat juridikë shqiptarë, ose kur vënia e garancisë është përjashtuar në bazë të parimit të reciprocitetit me shtetin, shtetësinë e të cilit ka paditësi;

b) nuk ka paraqitur kërkesë për vënien e garancisë në seancën gjyqësore në kohën kur i lind e drejta që t'i kërkojë gjykatës ushtrimin e saj;

c) pala paditëse ka fituar të drejtën e azilit në Republikën e Shqipërisë;

ç) nuk është në gjendje të tregojë se, bazuar në rrethanat e çështjes, ka një interes të ligjshëm për vënien e garancisë;

d) vënia e garancisë është përjashtuar në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare, të njohura nga shteti shqiptar.

3. Nëse brenda afatit të caktuar nuk vihet garancia, me kërkesë të palës së paditur, gjykata vendos pushimin e gjykimit.

Neni 84
Imuniteti diplomatik

Prona dhe pasuritë e personave fizikë dhe juridikë, që gëzojnë imunitet diplomatik, i nënshtrohen juridiksionit të gjykatave shqiptare, sipas rregullave të përcaktuara në marrëveshjet ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, ose në rast se një gjë e tillë pranohet vullnetarisht.

Neni 85
Emërimi i një personi të ngarkuar për të pranuar akte

1. Nëse një palë ka vendqëndrimin ose selinë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe nuk ka një përfaqësues në territorin e Republikës së Shqipërisë, gjykata mund të kërkojë që kjo palë, brenda një afati të arsyeshëm, të emërojë një person të autorizuar, të cilit mund t'i njoftohen akte në Republikën e Shqipërisë.

2. Nëse pala nuk emëron brenda këtij afati një person të autorizuar për të pranuar akte, asaj do t'i njoftohen të gjitha aktet me postë rekomande. Prezumohet që kjo palë i ka marrë aktet e dërguara 30 ditë pas dorëzimit në postë edhe nëse nuk ka një vërtetim për dorëzimin e tyre.

Neni 86
Ndihma juridike me gjykatat e shteteve të huaja

Ndihma e ndërsjellë juridike me gjykatat e shteteve të huaja rregullohet nga marrëveshjet ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga legjislacioni në fuqi.

KREU XI
DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 87
Dispozita kalimtare

Çështjet gjyqësore të papërfunduara, që janë në gjykim në gjykatë deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, gjykohen sipas ligjit në fuqi në kohën e depozitimit të padisë.

Neni 88
Shfuqizime

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet ligji nr.3920, datë 21.11.1964 "Për gëzimin e të drejtave civile nga të huajt", si dhe çdo dispozitë tjetër, që bie në kundërshtim me këtë ligj.

Neni 89
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.7017, datë 13.6.2011, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Bamir Topi

VENDIM
Nr.102, datë 16.6.2011

PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR EMËRIMIN E ZOTIT EDMOND ISLAMAJ ANËTAR I GJYKATËS SË LARTË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 136 pika 1 të Kushtetutës, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, bazuar në dekretin e Presidentit të Republikës nr.6682, datë 16.9.2010,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Dhënien e pëlqimit për emërimin e zotit Edmond Islamaj anëtar i Gjykatës së Lartë.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.103, datë 16.6.2011

PËR MOSDHËNIEN E PËLQIMIT PËR EMËRIMIN E ZONJËS MANJOLA BEJLERI ANËTARE E GJYKATËS SË LARTË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 136 pika 1 të Kushtetutës, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, bazuar në dekretin e Presidentit të Republikës nr.6683, datë 16.9.2010,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Mosdhënien e pëlqimit për emërimin e zonjës Manjola Bejleri anëtare e Gjykatës së Lartë.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.104, datë 16.6.2011

PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR EMËRIMIN E ZOTIT SHKËLZEN SELIMI ANËTAR I GJYKATËS SË LARTË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 136 pika 1 të Kushtetutës, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, bazuar në dekretin e Presidentit të Republikës nr.6684, datë 16.9.2010,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Dhënien e pëlqimit për emërimin e zotit Shkëlzen Selimi anëtar i Gjykatës së Lartë.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.105, datë 16.6.2011

PËR ZGJEDHJEN E ZOTIT ALFRED PRIFTI ANËTAR I KOMISIONIT TË SHËRBIMIT CIVIL

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Alfred Prifti zgjidhet anëtar i Komisionit të Shërbimit Civil, në vend të zotit Kostandin Kazanxhi, i cili ka dhënë dorëheqjen.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.406, datë 8.6.2011

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.413, DATË 26.5.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS E TË ORGANIKËS, SI DHE TË STRUKTURËS E TË NIVELEVE TË PAGAVE TË AUTORITETIT TË AVIACIONIT CIVIL"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 16 të ligjit nr.10 233, datë 11.2.2010 "Për Autoritetin e Aviacionit Civil" dhe të nenit 4 të ligjit nr.10 045, datë 23.4.2011 "Për kompetencat për përcaktimin e pagave dhe të shpërblimeve", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.413, datë 26.5.2010 të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Lidhja nr.1, që përmendet në pikën 1 të vendimit, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Në lidhjen 2, që përmendet në pikën 2 të vendimit, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në organikën e Autoritetit të Aviacionit Civil, shtohet Drejtoria e Ruajtjes së Cilësisë dhe Auditimit Teknik, me përbërje si më poshtë vijon:

"Drejtoria e Ruajtjes së Cilësisë dhe Auditimit Teknik

Drejtor	II-b	1
Inspektor	III-b	4

Numri i punonjësve në këtë drejtori është 5 veta.".

b) Në nënndarjen V, "Drejtoria e Aeroporteve dhe Sigurisë", në:

i) Sektorin e Mbikëqyrjes së Aeroporteve dhe të Certifikimit, shtohet një pozicion "Inspektor", kategoria III-b;

ii) Sektorin e Inspektimit të Pajisjeve Ndihmëse Navigacionale, shtohet një pozicion "Inspektor", kategoria III-b;

iii) Sektorin e Sigurisë dhe Koordinimit të Emergjencave, shtohet një pozicion "Inspektor", kategoria III-b.

Numri i punonjësve të nënndarjes V bëhet 8 veta.

c) Në fund të nënndarjes VI "Drejtoria e Sigurisë Ajrore", bëhet kjo shtesë:

"Sektori i Ekspertizës Mjekësore		(3)
Inspektor	III-b	3.".

Numri i punonjësve të nënndarjes VI bëhet 14 veta.

d) Në nënndarjen IX "Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse", bëhen këto ndryshime:

i) Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Sektori i Prokurimeve shkrihen dhe krijohet Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Prokurimeve, me përbërje si më poshtë vijon:

"Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Prokurimeve (3)

Përgjegjës sektori	III-a/1	1
Specialist	IV-a	2.".

ii) Sektori i Teknologjisë së Informacionit emërtohet "Sektori i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit".

Numri i punonjësve të nënndarjes IX nuk ndryshon, mbetet gjithsej 13 veta.

3. Numri gjithsej i punonjësve të Autoritetit të Aviacionit Civil bëhet 66 veta.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data e miratimit të tij.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

3342

STRUKTURA E AUTORITETIT TE AVIACIONIT CIVIL

LIDHJA I



UDHËZIM
Nr.12/2, datë 15.6.2011

PËR DISA SHTESA NË UDHËZIMIN NR.12, DATË 18.5.2011 "PËR PROCEDURAT E ZBATIMIT TË LIGJIT NR.10 418, DATË 21.4.2011 "PËR LEGALIZIMIN E KAPITALIT DHE FALJEN E NJË PJESE TË BORXHIT TATIMOR DHE DOGANOR"", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr.10 418, datë 21.4.2011 "Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor", Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.12, datë 18.5.2011 "Për procedurat e zbatimit të ligjit nr.10 418, datë 21.4.2011 "Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor"",të ndryshuar, bëhen shtesat e mëposhtme:

1. Pas shkronjës "b" të pikës 1 të sesionit II.1 "Falja e detyrimeve tatimore" shtohet shkronja "c" me këtë përmbajtje:

"c) Tarifat, kombëtare apo vendore, të cilat për nga natyra, mbledhja dhe administrimi i tyre, legjislacioni i ka njehsuar me taksat."

2. Në sesionin II.3 "Deklarimi vullnetar i detyrimit tatimor", në fund të pikës 1 shtohen fjalët:

"Në rast se kontrolli tatimor te tatimpaguesi ka filluar përpara datës së hyrjes në fuqi të ligjit nr.10 418, datë 21.4.2011 dhe udhëzimit nr.12, datë 18.5.2011 "Për procedurat e zbatimit të ligjit nr.10 418, datë 21.4.2011 "Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor"" dhe tatimpaguesit nuk i është dorëzuar raport kontrolli, atëherë tatimpaguesit i lihet afat 10 ditë kalendarike nga data e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, për të bërë vetëdeklarimin e detyrimeve tatimore, duke ndjekur procedurat e përcaktuara në pikën 2 dhe 3 të këtij sesioni. Në rast se brenda këtij afati 10-ditor, tatimpaguesi nuk ka bërë vetëdeklarimin e detyrimeve tatimore, atëherë kontrolli tatimor do të vazhdojë sipas ligjit të procedurave tatimore.".

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet ne Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

VENDIM
Nr.21, datë 3.6.2011

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar	i Gjykatës	Kushtetuese
Vladimir Kristo	Anëtar	i "	"
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i "	"
Petrit Plloçi	Anëtar	i "	"
Vitore Tusha	Anëtare	e "	"
Sokol Sadushi	Anëtar	i "	"
Admir Thanza	Anëtar	i "	"
Altina Xhoxhaj	Anëtare	e "	"
Sokol Berberi	Anëtar	i "	"

me sekretare Blerina Çinari, në datë 22.2.2011 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.akti 48/33 që i përket:

KËRKUES: Alfred Çaushi

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Ministria e Drejtësisë, përfaqësuar nga avokatët e shtetit Petrit Kaja dhe Abaz Deda me autorizim.

Zyra e Përmbarimit të Tiranës, në mungesë.

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor si rezultat i moszbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr.79, datë 10.6.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42 dhe 131/f të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Sokol Berberin, kërkuesin që u shpreh për pranimin e kërkesës, përfaqësuesit e subjektit të interesuar që u shprehën për rrëzimin e kërkesës dhe, pasi diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesi, Alfred Çaushi, ka punuar për 6 vjet si Shef i Sektorit të Përkthimit Zyrtar në Ministrinë e Drejtësisë. Në datën 4.7.2006, Drejtori i Drejtorisë së Bashkëpunimit Gjyqësor Ndërkombëtar në Ministrinë e Drejtësisë (MD) i ka komunikuar kërkuesit dhënien e masës disiplinore "Largim nga shërbimi civil".

2. Kërkuesi ka paraqitur ankim në Komisionin e Shërbimit Civil (KSHC), i cili, me vendimin nr.651, datë 24.10.2006, ka vendosur: pranimin e kërkesës së kërkuesit, shfuqizimin e aktit të mësipërm, si të pabazuar në ligj dhe në prova, kthimin e kërkuesit në vendin e mëparshëm të punës, pagesën e tij për periudhën e qëndrimit pa punë nga data e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës deri në momentin e ekzekutimit të vendimit të KSHC-së.

3. MD-ja ka kundërshtuar këtë vendim të KSHC-së në Gjykatën e Apelit Tiranë. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.79, datë 10.6.2008, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.651, datë 24.10.2006 të KSHC-së. Kundër këtij vendimi nuk është ushtruar rekurs. MD-ja ka kërkuar rivendosje në afat të së drejtës së ankimit kundër vendimit nr.79 të mësipërm. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.376, datë 15.7.2010, ka vendosur rrëzimin e kërkesës për rivendosje në afat. MD ka ushtruar rekurs kundër vendimit të mësipërm, rekurs që ende nuk është shqyrtuar.

4. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.95, datë 15.7.2008 ka vendosur lëshimin e urdhrit të ekzekutimit ndaj vendimit nr.79, datë 10.6.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Zyra e Përmbarimit Tiranë ka njoftuar Ministrinë e Drejtësisë për ekzekutimin vullnetar të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë.

5. Nga MD-ja është bërë padi në Gjykatën e Rrethit Tiranë me objekt "pavlefshmëri të titullit ekzekutiv" (përkatësisht të vendimit nr.79, datë 10.6.2008) dhe pezullimin e ekzekutimit të tij. Gjykata Rrethit Gyqësor Tiranë, ka vendosur rrëzimin e kërkesës.

6. Kërkuesi, përpara Gjykatës Kushtetuese kërkon konstatimin e cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor si rezultat i mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr.79, datë 10.6.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë, duke pretenduar:

- Zyra e Përmbarimit Tiranë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit nuk kanë hedhur asnjë hap për të detyruar Ministrinë e Drejtësisë për zbatimin e vendimit objekt kërkese;

- Zyra e Përmbarimit, duke qenë hallkë në vartësi të drejtpërdrejtë të Ministrisë së Drejtësisë, nuk ka aftësinë dhe mundësinë reale të detyrojë eprorin e vet në zbatimin e një vendimi për të cilin paraardhësi i tij është fajtor;

- Ministria e Drejtësisë nuk ka ushtruar rekurs për vendimin nr.79, datë 10.6.2008, pra vendimi është i formës së prerë ose përfundimtar dhe nuk mund të ankimohet;

- Pretendimi se Ministria e Drejtësisë nuk ka pasur dijeni për vendimin nuk qëndron. Ky vendim është njoftuar me shkresën nr.549/09, datë 17.8.2009 të Zyrës së Përmbarimit Tiranë për ekzekutimin vullnetar të vendimit në fjalë.

- Moszbatimi i vendimit të formës së prerë është në kundërshtim të hapur me Kushtetutën, KEDNJ-në dhe legjislacionin në fuqi.

7. Subjekti i interesuar, Ministria e Drejtësisë parashtron se:

- Kërkuesi nuk legjitimohet pasi ai nuk ka shteruar mjetet e tjera ligjore para se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese.

- Në çështjen "Gjyli kundër Shqipërisë", Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), ka arsyetuar se kur një vendim gjyqësor konsiderohet përfundimtar ose kur një vendim quhet i formës së prerë. Interpretimi i detajuar i neneve 442 dhe 451 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), nën frymën e KEDNJ-së dhe jurisprudencës së GJEDNJ-së, do të orientonte praktikën gjyqësore në drejtimin e duhur, duke vendosur përfundimisht se një vendim konsiderohet i formës së prerë, pasi të ketë ezauruar gjykimin në Gjykatën e Lartë, në rast të paraqitjes së rekursit.

- Ministria e Drejtësisë ka paraqitur rekurs ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit i cili deri në këto momente nuk është shqyrtuar.

- Periudha që duhet të merret parasysh si afat i arsyeshëm duhet të fillojë nga data e përfundimit të çështjes në Gjykatën e Lartë.

- Shqyrtimi i rekursit në Gjykatën e Lartë, megjithëse nuk i takon të ndërhyjë në thelbin e çështjes, mund të sjellë pasoja mbi zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

- Bazuar në rrethanat e çështjes nuk ka vonesë në ekzekutimin e vendimit gjyqësor.

II

A. *Për legjitimimin e kërkuesit*

8. Subjekti i interesuar, Ministria e Drejtësisë, ka pretenduar përpara Gjykatës Kushtetuese se kërkuesi nuk legjitimohet, pasi ai nuk ka shteruar mjetet e tjera ligjore para se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese. Ministria e Drejtësisë ka paraqitur rekurs ndaj vendimit nr.376, datë 15.7.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë, i cili deri në këto momente nuk është shqyrtuar.

9. Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, ka vlerësuar se shterimi i mjeteve juridike nënkupton që ankuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete. (*Vendimet nr.6, datë 31.3.2006 dhe nr.27, datë 20.6.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Shterimi i mjeteve të ankimit është trajtuar edhe nga jurisprudenca e GJEDNJ-së, e cila në çështjen "Qufaj kundër Shqipërisë" është shprehur se ankuesit duhet të përdorin mjetet ligjore, që sipas sistemit juridik të brendshëm, janë zakonisht në dispozicion të palëve dhe të mjaftueshme për të vënë në vend të drejtat e shkelura.

10. Shterimi i mjeteve është parakusht që duhet përmbushur nga ankuesi, i cili para se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura.

11. Gjatë hetimit të çështjes rezultoi se asnjë instancë gjyqësore nuk ka shfuqizuar ose ndryshuar vendimin nr.651, datë 24.10.2006 të KSHC-së, në të cilin urdhërohet subjekti i interesuar, MD-ja të kthejë kërkuesin në vendin e mëparshëm të punës dhe t'i paguajë pagën për të gjithë kohën e qëndrimit padrejtësisht pa punë nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare. Gjithashtu, asnjë instancë gjyqësore nuk ka shfuqizuar ose ndryshuar vendimin nr.95, datë 15.7.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë, i cili ka vendosur lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për vendimin e formës së prerë nr.79, datë 10.6.2008, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

12. Pretendimi i subjektit të interesuar, MD-së, se kërkuesi nuk ka shteruar të gjitha mjetet juridike me argumentin, se duhet të pritet dhe shqyrtimi i rekursit në Gjykatën e Lartë, është i pambështetur. Gjykata vëren se MD-ja ka ushtruar rekurs kundër vendimit nr.376, datë 15.7.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë, nëpërmjet të cilit është vendosur rrëzimi i kërkesës së MD-së për rivendosje në afat. Nëpërmjet rekursit nuk janë kundërshtuar vendimi nr.651, datë 24.10.2006 të KSHC-së dhe vendimi i formës së prerë nr.79, datë 10.6.2008, të Gjykatës së Apelit Tiranë, të cilat janë objekt i këtij gjykimi për sa i përket ekzekutimit.

13. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson, se kërkuesi ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtën e shkelur.

B. *Për pretendimin se kërkuesit i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor për shkak të mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm*

14. Gjykata është shprehur edhe më parë se ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i një vendimi të formës së prerë të gjykatës është pjesë përbërëse e të drejtës për një proces të rregullt ligjor në kuptim të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së (*Vendimet nr.27, datë 20.6.2007 dhe nr.6, datë 6.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Ekzekutimi i vendimit është një element thelbësor i shtetit të së drejtës e i vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre (*Vendimet nr.6, datë 31.3.2006 dhe nr.6, datë 6.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Gjykata është shprehur edhe më parë se autoritetet shtetërore nuk mund të përmendin mungesën e fondeve si justifikim për të mos respektuar një detyrim financiar që vjen nga një vendim gjyqësor (Vendimi *nr.6, datë 6.3.2009 i Gjykatës Kushtetuese)*. Një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (*Vendimi nr.43, datë 19.12.2007 i Gjykatës Kushtetuese*).

15. Gjykata është shprehur se kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen e aplikantit dhe të autoriteteve përkatëse, si dhe interesin e kërkuesit. Për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara, vëllimin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme. (*Vendimet nr.6, datë 31.3.2006; nr.43, datë 19.12.2007*; *nr.6, datë 6.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Gjykata rikonfirmon qëndrimin se në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore, deri në momentin kur jepet dhe ekzekutohet vendimi. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces.

17. Me qëllim analizimin e sjelljes së palëve në dritën e standardeve kushtetuese, në çështjen objekt shqyrtimi, merren në konsideratë edhe dispozitat e Kodit të Procedurës Civile (KPC) për zbatimin e vendimeve gjyqësore. Këto dispozita sqarojnë procedurat ligjore, të cilat duhen plotësuar për ekzekutimin e një vendimi gjyqësor.

18. Çështja objekt gjykimi nuk paraqet kompleksitet nga pikëpamja faktike ose ligjore, çka mund të justifikonte vonesat apo sjelljen mosvepruese të organeve të ngarkuara nga ligji, MD-ja dhe Zyra e Përmbarimit. Për sa i përket sjelljes (veprimeve) së kërkuesit, Gjykata konstaton se kërkuesi ka vepruar në përputhje me të drejtat e tij procedurale, duke shteruar mjetet ligjore në dispozicion të tij për rivendosjen e së drejtës së cenuar.

19. Zyra e Përmbarimit Tiranë ka bërë "Lajmërim për ekzekutim vullnetar" nr.549/09 datë 17.8.2009. Ministria e Drejtësisë nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për ekzekutim. Përmbaruesi gjyqësor, si subjekt procedural në fushën e ekzekutimit, është i pajisur me të gjitha mjetet procedurale që mundësojnë ekzekutimin e titullit ekzekutiv. Gjykata vlerëson se veprimet e kryera nga përmbaruesi gjyqësor kanë qenë të pasuksesshme për shkak të mosushtrimit të të gjithë kompetencave nga ana e tij. Gjykata Kushtetuese vlerëson se përballë detyrimit për zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të gjitha subjektet, qofshin këto private apo publike, duhet të përgjigjen njëlloj.

20. Gjykata vëren se "urdhri ekzekutiv" i lëshuar nga Gjykata e Apelit Tiranë mban datën 15.7.2008. Pra, kanë kaluar më shumë se dy vjet nga data që ka dalë ky urdhër ekzekutimi dhe ai ende nuk është zbatuar. Gjykata vlerëson se MD-ja nuk ka paraqitur argumente bindëse lidhur me arsyet përse nuk është ekzekutuar vendimi gjyqësor i formës së prerë. Argumenti, se periudha nga e cila duhet të fillojë të përllogaritet afati i arsyeshëm për ekzekutimin e vendimit gjyqësor është nga

data kur të përfundojë çështja në Gjykatën e Lartë, nuk qëndron. Asnjë instancë gjyqësore nuk ka shfuqizuar ose ndryshuar vendimin nr.95, datë 15.7.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë, i cili ka vendosur lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për vendimin e formës së prerë nr.79, datë 10.6.2008, të Gjykatës së Apelit Tiranë. Gjykata rithekson se afati i arsyeshëm fillon nga data e lëshimit të urdhrit të ekzekutimit të vendimit, i cili është përfundimtar dhe ka marrë formë të prerë.

21. Për sa më sipër, Gjykata Kushtetuese nuk gjen arsye të bazuara që kanë çuar në mosrealizimin e të drejtës së kërkuesit për një proces të rregullt ligjor. Gjykata vlerëson se në çështjen në shqyrtim, Zyra e Përmbarimit dhe MD-ja, i kishin të gjitha mundësitë që gjatë gjithë periudhës nga dita e marrjes formë të prerë të vendimit e në vazhdim të ekzekutonin vendimin e formës së prerë.

22. Gjykata, në vijim të arsyetimit të mësipërm, në çështjen objekt shqyrtimi, vëren se mosekzekutimi i vendimit të formës së prerë ka sjellë cenimin e të drejtës së kërkuesit për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe nenit 6/1 të KEDNJ-së.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/g të Kushtetutës, si dhe në nenin 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr.79, datë 10.6.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Sokol Sadushi, Vitore Tusha, Petrit Plloçi, Sokol Berberi, Altina Xhoxhaj, Admir Thanza
Anëtar kundër: Xhezair Zaganjori

VENDIM
Nr.22, datë 6.6.2011

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Vladimir Kristo	Anëtar i " "
Xhezair Zaganjori	Anëtar i " "
Vitore Tusha	Anëtare e " "
Sokol Sadushi	Anëtar i " "
Sokol Berberi	Anëtar i " "
Admir Thanza	Anëtar i " "
Altina Xhoxhaj	Anëtare e " "
Petrit Plloçi	Anëtar i " "

me sekretare Blerina Çinari, në datë 13.1.2011, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.39/24 Akti që i përket:

KËRKUES: Kasem Berami, Arif Berami, Mehmet Berami, Haxhi Berami, Syrja Berami, Klareta Berami të përfaqësuar nga avokatët Roland Samarxhi dhe Oltion Samarxhi, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Azis Bajrami, Gëzim Bajrami, Besnik Bajrami, Kujtim Bajrami, Majlinda (Shkoza) Bajrami, Irma (Hodaj) Bajrami, Hajrije Bajrami, Altin Bajrami,

Leonard Bajrami, Natasha Haruni, Yllka (Nelku) Haruni, Merushe Haruni, Xhiliana Vako (Haruni), Nuredin Berami të përfaqësuar nga avokati Avni Shehu, me prokurë.

Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën, i vendimit nr.980, datë 1.8.2007 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe i vendimit nr.1177, datë 16.10.2009 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42/2, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Petrit Plloçi; përfaqësuesin e kërkuesit, avokatin Roland Samarxhi që kërkoi pranimin e kërkesës, përfaqësuesin e personave të interesuar, avokatin Avni Shehu që kërkoi rrëzimin e kërkesës, dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN*:*

I

Ali Sheh Bajrami ka lënë si trashëgimtarë ligjorë dy djem, të quajturit Mustafa Bajrami dhe Mehmet Berami (Bajrami). Trashëgimtarët ligjorë të Mustafa Bajramit kanë ngritur padi kundër trashëgimtarëve ligjorë të Mehmet Beramit (Bajramit) dhe KKKP-së, Tiranë, duke kërkuar anulimin e pjesshëm të vendimit nr.410, datë 4.10.1995 të KKKP-së së Tiranë dhe detyrimin e paditësve për t'i njohur ata bashkëpronarë mbi objektin e këtij vendimi, me pretendimin se prona ishte në bashkëpronësi të dy grupeve të trashëgimtarëve.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr.3174, datë 15.7.2002, ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë. Ky vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është ndryshuar me vendimin nr.1219, datë 24.11.2003 të Gjykatës së Apelit Tiranë, duke vendosur pranimin e padisë. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.229 datë 23.12.2004, ka vendosur prishjen e vendimit nr.1219 datë 24.11.2003 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim po në atë gjykatë me tjetër trup gjykues.

Në rigjykim, Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr.980, datë 1.8.2007, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr.3174, datë 15.7.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe pranimin e padisë. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në Dhomën e Këshillimit, me vendimin nr.1177, datë 16.10.2009, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga të padituri Kasem Berami, Nuredin Berami, Arif Berami kundër vendimit nr.980 datë 1.8.2007 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Në datën 26.2.2010 kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) duke kërkuar shfuqizimin si jokushtetues të vendimit nr.980, datë 1.8.2007 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe vendimit nr. 1177, datë 16.10.2009, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, duke pretenduar se këto vendime janë marrë në cenim të së drejtës së tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor për arsye se:

- është cenuar standardi kushtetues i gjykimit nga një gjykatë e paanshme për shkak se dy nga gjyqtarët e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, kishin shprehur më parë mendim për çështjen në gjykim;
- një sërë aktesh procedurale të administruara gjatë gjykimit në gjykatën e apelit dhe për rrjedhojë edhe në Gjykatën e Lartë, kanë qenë të parregullta,
- gjatë rigjykimit në gjykatën e apelit nuk u zbatuan detyrat e lëna nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin nr.229, datë 23.12.2004, çka vjen në vjen në kundërshtim me nenin 493 të Kodit të Procedurës Civile;
- për natyrën e shkaqeve të ngritura në rekurs, Gjykata e Lartë duhet ta kalonte çështjen për shqyrtim në seancë gjyqësore dhe jo ta shqyrtonte atë në Dhomën e Këshillimit.

II

1. Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykim

Kërkuesit në kërkesën drejtuar Gjykatës kanë pretenduar se dy nga gjyqtarët, që kanë shqyrtuar çështjen në Gjykatën e Lartë në Dhomën e Këshillimit kishin shprehur më parë mendim për themelin e kësaj çështjeje, duke u vënë në kushtet e papajtueshmërisë, në kuptim të nenit 72/4 të KPC-së.

Në këtë drejtim, Gjykata rithekson jurisprudencën e saj të mëparshme se, një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, është ai i paanshmërisë së gjykatës në gjykimin e çështjes. Në këtë kuadër, Gjykata thekson se parimi i paanshmërisë ka në vetvete elementin *subjektiv*, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin *objektiv* me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimit prej saj të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim. Në shtetin e së drejtës, kjo kërkesë merr rëndësi të veçantë në funksion të besimit në dhënien e drejtësisë që duhet të krijojnë në çdo rast në shoqërinë demokratike jo vetëm palët në gjykim, por çdo qytetar *(Shih vendimin nr.12, datë 13.4.2007 të Gjykatës Kushtetuese)*.

Gjykata, në rastin në shqyrtim, vëren se një gjyqtare ka qenë si në përbërjen e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, që ka dhënë vendimin nr.229, datë 23.12.2004 në të cilin është vendosur kthimi i çështjes për rigjykim në gjykatën e apelit, ashtu edhe në përbërjen e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë që në Dhomën e Këshillimit ka dhënë vendimin, objekt kërkese, në të cilin është vendosur mospranimi i rekursit. Gjykata vëren se vendimi nr.229, datë 23.12.2004 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është një vendim për kthimin e çështjes për rigjykim. Si i tillë, ky vendim nuk i jep fund procesit dhe ka fuqi detyruese vetëm brenda këtij procesi, çka e bën këtë vendim të jetë jo një vendim përfundimtar themeli që zgjidh çështjen në gjykim. Nisur nga natyra e vendimit nr.229, datë 23.12.2004, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë Gjykata çmon se gjyqtarët që kanë dhënë këtë vendim, duke përfshirë këtu edhe gjyqtaren, për të cilën ngrihet pretendimi për anësi në gjykim, nuk kanë dhënë mendim për zgjidhjen e themelit të çështjes. Për këtë arsye Gjykata vlerëson se, edhe pse gjyqtarja për të cilën ngrihet pretendimi për anësi në gjykim, ka qenë në përbërjen e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë që ka dhënë vendimin objekt kërkese, përsëri ajo nuk ka cenuar qoftë elementin objektiv ashtu edhe atë subjektiv të paanësisë.

Gjykata vëren gjithashtu se një tjetër gjyqtare ka qenë si në përbërjen e trupit gjykues që ka dhënë vendimin nr.2342, datë 18.3.1994 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në të cilin është vendosur *vërtetimi i faktit juridik i qenies pronar i Mehmet Beramit (Bajramit) mbi pronën objekt gjykimi*, ashtu edhe në përbërjen e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë që, në Dhomën e Këshillimit, ka dhënë vendimin e kundërshtuar. Gjykata referuar vendimit nr.2342, datë 18.3.1994 vlerëson se gjykimi, mbi bazë të së cilit është dhënë ky vendim, ka qenë një gjykim pa palë kundërshtare, pra një gjykim jokontencioz, i mbështetur në nenet 388-392 të Kodit të Procedurës Civile. Për pasojë, vendimi gjyqësor që është dhënë në përfundim të këtij gjykimi është thjesht deklarativ, i cili, në bazë të nenit 391 të Kodit të Procedurës Civile ka fuqi provuese vetëm për kërkuesin dhe jo për personat e tjerë që nuk janë thirrur në këtë gjykim. Nisur nga natyra e këtij gjykimi, si një gjykim jokontencioz, rezulton se ky gjykim ka prodhuar një vendim thjesht deklarativ. Për këtë arsye, Gjykata vlerëson se gjyqtarja, për të cilën ngrihet pretendimi i paanësisë në gjykim në dhënien e këtij vendim, nuk ka shprehur mendim për çështjen në gjykim, në të cilin është dhënë vendimi nr.1177, datë 16.10.2009 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, objekt i kundërshtimit kushtetues.

2. Lidhur me pretendimin mbi parregullsitë e disa akteve procedurale

Kërkuesit kanë pretenduar, gjithashtu, se disa akte procedurale që i përkasin gjykimit në gjykatën e apelit dhe, për rrjedhojë, edhe në Gjykatën e Lartë, kanë patur parregullsi.

Gjykata Kushtetuese vëren se ky pretendim nuk është ngritur dhe nuk gjen pasqyrim në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë kundër vendimit nr.980, datë 1.8.2007 të Gjykatës së Apelit Tiranë, objekt kërkese. Parë në këtë këndvështrim, Gjykata çmon se kërkuesit nuk kanë shteruar mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtës për një proces të rregull ligjor, parakusht ky i sanksionuar në nenin 131 shkronja "f" të Kushtetutës. Për rrjedhojë, ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim nga Gjykata.

3. Lidhur me pretendimin për moszbatimin e udhëzimeve të Gjykatës së Lartë

Kërkuesit kanë pretenduar se, gjatë rigjykimit në Gjykatën e Apelit nuk janë zbatuar udhëzimet e lëna nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin nr.229, datë 23.12.2004, çka vjen në kundërshtim me nenin 493 të Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata çmon se nuk i takon kësaj gjykate të verifikojë në këtë drejtim. Nëse zbatohen ose jo udhëzimet e kolegjeve të Gjykatës së Lartë, u takon pikërisht këtyre kolegjeve ta verifikojnë e jo Gjykatës Kushtetuese.

4. Pretendimi për cenimin e të drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj.

Gjykata rithekson se, bazuar në nenin 480 të Kodit të Procedurës Civile, është në kompetencë të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë që në Dhomë të Këshillimit të analizojë dhe të vlerësojë nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit. Në rast se Kolegji në Dhomën e Këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs objektivisht nuk ekzistojnë në dosjen gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore. Nga pikëpamja kushtetuese, vetëm kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, atëherë vendimi i Kolegjit, për mospranimin e rekursit, vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor (vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.19, datë 19.7.2005)".

Gjykata, për sa më sipër, vlerëson se në rastin konkret, zgjidhja e çështjes me mospranim në Dhomë Këshillimi nuk u ka cenuar kërkuesve të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

Gjykata arrin në përfundimin se, në tërësinë e tij procesi i zhvilluar në të tri shkallët e gjykimit ka qenë i rregullt në aspektin kushtetues.

Për pasojë, kërkesa e paraqitur nga kërkuesit rrëzohet si e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Sokol Berberi,Sokol Sadushi, Vitore Tusha, Petrit Plloçi, Altina Xhoxhaj, Admir Thanza

VENDIM
Nr.23, datë 8.6.2011

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar	i	Gjykatës	Kushtetuese
Vladimir Kristo	Anëtar	i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“	“
Petrit Plloçi	Anëtar	i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare	e	“	“
Sokol Sadushi	Anëtar	i	“	“
Sokol Berberi	Anëtar	i	“	“
Admir Thanza	Anëtar	i	“	“

me sekretare Blerina Çinari, në datën 11.1.2011 mori në shqyrtim, në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr.38/23 Akti që i përket:

KËRKUES: Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar me autorizim nga Lulzim Lelçaj.

Këshilli i Ministrave, përfaqësuar me autorizim nga Marsida Xhaferllari.

Prokuroria e Përgjithshme, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën, i nenit 15/a të ligjit nr.9794, datë 23.7.2007 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”

BAZA LIGJORE: Nenet 134/1, shkronja “d” dhe 145/2 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Bashkim Dedja, shqyrtoi pretendimet e kërkuesit; parashtrimet e subjekteve të interesuara: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave, të cilët kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës dhe, pasi e diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës (gjykata referuese) me datë 29.9.2010, ka vendosur pezullimin e gjykimit të çështjes penale nr.1421, datë 15.4.2009 në ngarkim të të pandehurve F.I., S.D., TH.ZH., A.R., AXH, akuzuar për kryerjen e veprës penale të ndërtimit pa leje, sipas nenit 15/a të ligjit nr.9794, datë 23.7.2007 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” dhe dërgimin e çështjes Gjykatës Kushtetuese.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës i ka kërkuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) që të shfuqizojë, si të papajtueshëm me Kushtetutën, nenin 15/a të ligjit nr.9794, datë 23.7.2007 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”.

Ky nen ka këtë përmbajtje: *“Kryerja e punimeve të ndërtimit pa leje ndërtimi me pasojë krijimin e sipërfaqeve ndërtimore përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në 2 vjet. Kryerje e punimeve të ndërtimit me pasojë shtesa në sipërfaqe ndërtimore tej lejes së ndërtimit përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në 2 vjet”.*

Kërkuesi ka pretenduar se neni 15/a i ligjit nr.9794, datë 23.7.2007 është në kundërshtim me kriterin formal të miratimit të ligjeve bazuar në nenin 81/2, shkronja “d” të Kushtetutës, që kërkon shumicë të cilësuar për përcaktimin e veprave penale.

Kuvendi, si palë e interesuar, ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, duke parashtruar këto shkaqe:

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës nuk legjitimohet, sepse ka pasur mundësi ta zgjidhë çështjen pa iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, duke iu referuar nenit 199/a të Kodit Penal. Kodi i Procedurës Penale i jep mundësi gjykatës të ndryshojë cilësimin juridik të veprës penale, ndryshe nga sa ka përcaktuar Prokurori në akuzë, pa pasur nevojë të pezullojë gjykimin dhe të kërkojë kontroll incidental të normës juridike penale.

2. Gjykatat nuk kanë tagër të pakufizuar që të kërkojnë papajtueshmëri të ligjeve me Kushtetutën edhe për mosrespektim të kritereve formale të miratimit të ligjeve, pasi shndërrohen si subjektet e tjera të pakushtëzuara, të përcaktuara në nenin 134/1 nga shkronja "a" deri te shkronja "ç" të Kushtetutës.

Këshilli i Ministrave, si palë e interesuar, ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, duke parashtruar këto shkaqe:

1. Kushtetuta si burim kryesor i së drejtës penale pranon rregullimin e aspekteve të veçanta të së drejtës penale qoftë me Kodin Penal, qoftë me ligj të cilësuar ose të thjeshtë. Koncepti "kod penal" nuk mund të njehsohet me konceptin "ligj penal" dhe këto dy koncepte nuk mund të përdoren në zëvendësim të njëri-tjetrit rast pas rasti.

2. Neni 116 i Kushtetutës në hierarkinë e normave përcakton ligjet si burime të së drejtës, pa bërë një kategorizim të llojit të ligjeve. Rrjedhimisht, koncepti "ligj", i përmendur në këtë dispozitë, nënkupton çdo lloj ligji të miratuar nga Kuvendi, pavarësisht procedurës, lëndës e strukturës së tij.

3. Neni 81/2 i Kushtetutës përcakton një listë shteruese, për ligjet të cilat miratohen me tre të pestat e të gjithë anëtarëve, përfshirë dhe kodet, që nënkupton se pjesa tjetër e ligjeve miratohen me shumicë të thjeshtë. Ky nen njeh rezervën e përforcuar për përmbajtjen dhe rezervën e përforcuar për procedurën. Shkronja"d" e nenit 81/2 të Kushtetutës, ku bëhet fjalë për kodet, njeh rezervën e përforcuar për procedurën (3/5 e të gjithë anëtarëve të Kuvendit) pa përcaktuar përmbajtjen.

II

A. Për legjitimimin e kërkuesit

Subjekti i interesuar, Kuvendi, ka parashtruar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës nuk legjitimohet, sepse zgjidhja e kësaj çështjeje mundësohej nga kërkuesi edhe pa iu drejtuar Gjykatës. Sipas Kuvendit, lidhja e drejtpërdrejtë mes ligjit objekt i kërkesës dhe zgjidhjes së çështjes konkrete, kërkon që gjykata, duke gjykuar një çështje konkrete, të mos ketë mundësi të përdorë një normë tjetër ligjore për zgjidhjen e saj. Në rastin konkret gjykata ka pasur mundësi ta zgjidhë çështjen duke iu referuar nenit 199/a të Kodit Penal.

Gjykata thekson se neni 145, pika 2 e Kushtetutës i njeh të drejtën gjyqtarëve, që në çdo fazë të gjykimit, kur ata çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën, të mos i zbatojnë ato. Në këtë rast, ata pezullojnë gjykimin dhe ia dërgojnë çështjen Gjykatës Kushtetuese.

Gjykata është shprehur në vazhdimësi për aspektet e legjitimimit të gjykatave, të cilat e vënë në lëvizje atë nëpërmjet kontrollit incidental. Sipas kësaj Gjykate: … ligji nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", në nenin 68, përcakton disa kushte, të cilat duhet të respektohen nga gjykata ose gjyqtari për të kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së ligjit përpara Gjykatës Kushtetuese. *Së pari,* gjykata ose gjyqtari, gjatë një procesi gjyqësor duhet të përcaktojë/identifikojë ligjin që zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete; *së dyti,* duhet të parashtrojë arsye serioze për jokushtetutshmërinë e këtij ligji (të një ose të disa dispozitave të ligjit) duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës. (…) Në mënyrë që të ekzistojë lidhja e drejtpërdrejtë duhet të ketë një raport të domosdoshëm mes vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe zgjidhjes së çështjes kryesore nga gjyqtari apo gjykata, subjekt iniciues i gjykimit incidental, në kuptimin, që gjykimi nga gjykata e zakonshme nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga gjykimi në Gjykatën Kushtetuese". *(shih vendimet: nr.30/2010; nr.18/2010; nr.12/2010; nr.2/2010; nr.13/2009; nr.5/2009; nr.14/2008; nr.11/2008; nr.3/2008; nr.21/2007; nr.33/2007; nr.3/2006 të Gjykatës Kushtetuese)*.

Gjykata referuese ka pasur në shqyrtim çështjen penale nr.1421, datë 15.4.2009 në ngarkim të të pandehurve F.I., S.D., TH.ZH., A.R., A.XH., akuzuar për kryerjen e veprës penale të ndërtimit pa leje, sipas nenit 15/a të ligjit nr.9794, ku përcaktohet se "*Kryeja e punimeve të ndërtimit pa leje ndërtimi me pasojë krijimin e sipërfaqeve ndërtimore përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në 2 vjet. Kryerje e punimeve të ndërtimit me pasojë shtesa në sipërfaqe ndërtimore tej lejes së ndërtimit përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në 2 vjet"*. Gjykata referuese gjatë gjykimit ka vlerësuar se ky nen është i papajtueshëm me nenin 81/2 të Kushtetutës, prandaj dhe Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se ekziston lidhja e drejtpërdrejtë midis zgjidhjes së çështjes konkrete dhe dispozitës ligjore që kundërshtohet për papajtueshmëri me Kushtetutën.

B. Mbi pretendimin për mosrespektimin e kushteve të përcaktuara nga neni 81/2 i Kushtetutës

Kërkuesi ka parashtruar se neni 15/a i ligjit nr.9794, ku përcaktohet se *"Kryerja e punimeve të ndërtimit pa leje ndërtimi me pasojë krijimin e sipërfaqeve ndërtimore përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në 2 vjet. Kryerja e punimeve të ndërtimit me pasojë shtesa në sipërfaqe ndërtimore tej lejes së ndërtimit përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në 2 vjet",* është antikushtetues, pasi nuk është zbatuar kriteri formal i miratimit të veprave penale me "shumicë e cilësuar" në përputhje me nenin 81/2, shkronja "d'" të Kushtetutës.

Pala e interesuar, Këshilli i Ministrave ka pretenduar se kriteri kushtetues "shumicë e cilësuar" nuk duhet të zbatohet për sanksionimin e veprave penale, pasi kërkesa e nenit 81/2, shkronja "d" të Kushtetutës ka lidhje me rezervën ligjore të përforcuar, jo për shkak përmbajtjeje, por për shkak procedure. Sipas këtij subjekti, Gjykata duhet të bëjë një interpretim evolutiv të Kushtetutës për parimin e ligjshmërisë në të drejtën penale dhe me konceptet e ligjeve të thjeshta dhe të cilësuara. Kushtetuta si burim kryesor i së drejtës penale pranon rregullimin e aspekteve të veçanta të së drejtës penale qoftë me Kodin Penal, qoftë me ligj të cilësuar ose të thjeshtë. Koncepti "kod penal" nuk mund të njehsohet me konceptin "ligj penal" dhe këto dy koncepte nuk mund të përdoren në zëvendësim të njëri-tjetrit rast pas rasti.

Gjykata ka vlerësuar se Kodi Penal përbën ligjin më të rëndësishëm, ku përmblidhen në mënyrë të sistemuar dispozitat penalo-juridike. Një nga parimet kryesore që përshkon këtë Kod është edhe parimi i ligjshmërisë që nënkupton parashikimin me ligj të veprave penale dhe mosdënimin për një vepër që nuk është parashikuar shprehimisht si krim ose kundërvajtje penale. Qëllimi i këtij parimi është jo vetëm respektimi i ligjit për çdo rast dhe për çdo vepër penale, por edhe njohja e subjekteve me të gjitha ato veprime ose mosveprime, të cilat konsiderohen të dënueshme. Duke qenë se Kodi Penal, krahas Kushtetutës, është burimi kryesor i të drejtës penale dhe në zbatim të parimit të ligjshmërisë, parashikimi i veprave penale duhet të bëhet pikërisht në këtë Kod, si ligji bazë që parashikon krimet dhe kundërvajtjet penale ose në një ligj të barasvlershëm me të nga fuqia juridike (*shih vendimin nr.3, datë 5.2.2010 të Gjykatës Kushtetuese)*.

Gjykata është shprehur se shpërndarja e normave juridiko-penale në ligje të ndryshme, si dhe ndryshimet e shpeshta në legjislacionin penal, nuk i shërbejnë stabilitetit juridik të vendit, si një kusht i rëndësishëm për funksionimin e shtetit të së drejtës *(shih vendimin nr.1, datë 12.1.2011 të Gjykatës Kushtetuese)*.

Gjykata ka theksuar se Kushtetuta u jep ligjeve të përforcuara fuqi të veçantë juridike në krahasim me aktet e zakonshme të ligjvënësit. Për këtë arsye, në hierarkinë e akteve, ligjet e përforcuara renditen para ligjeve të zakonshme të Kuvendit *(shih vendimet nr.9, datë 23.3.2010 dhe nr.19, datë 3.5.2007 të Gjykatës Kushtetuese)*. Në nenin 4/2 të Kushtetutës deklarohet: "Kushtetuta është ligji më i lartë në Republikën e Shqipërisë". Deklarimi i epërsisë së Kushtetutës, duke e vendosur në majë të piramidës së normave juridike, është një aspekt thelbësor i parimit të shtetit të së drejtës. Ky parim detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese. Aktet juridike, që nxirren nga këto organe, duhet të jenë në pajtim me aktet juridike me të larta, si në kuptimin formal, ashtu edhe atë material *(shih vendimet: nr.19, datë 3.5.2007; nr.3, datë 20.2.2006; nr.29, datë 9.11.2005 të Gjykatës Kushtetuese)*.

Gjykata vëren se sipas nenit 81/2 të Kushtetutës miratohen me tre të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit (ligj i përforcuar): a) ligjet për organizimin dhe funksionimin e institucioneve të parashikuara nga Kushtetuta; b) ligji për shtetësinë; c) ligji për zgjedhjet e përgjithshme dhe vendore; ç) ligji për referendumet; *d) kodet;* dh)…

Sipas kësaj Gjykate, kushtetutbërësi nëpërmjet nenit 81/2, shkronjat "a", "b", "c" "ç","dh", "e", "ë", "f" ka përcaktuar ligjet që kërkojnë shumicë të cilësuar sipas objektit dhe përmbajtjes së tyre (p.sh. shtetësia, zgjedhjet, referendumet), por ka lënë jashtë këtij përcaktimi shkronjën "d" të nenit ku bëhet fjalë për kodet. Për kuptimin e nenit 81/2, shkronja "d" të Kushtetutës, Gjykata çmon t'i referohet interpretimit historik, logjik, teleologjik të kësaj dispozite, duke pasur parasysh kontekstin në të cilin është miratuar. Praktika e deriatëhershme legjislative ishte e tillë që veprat penale të përmblidheshin në mënyrë të kodifikuar. Kushtetuta është miratuar në vitin 1998, periudhë kur veprat penale i kishim të sanksionuara në kodin penal, por edhe para viteve '90 sanksionimi i veprave penale ishte realizuar në kodet penale përkatësisht të viteve 1952 dhe 1977. Për rrjedhojë, për shkak të kësaj tradite legjislative në vijimësi, pas fjalës "kode", në shkronjën "d" të nenit 81/2 të Kushtetutës, objekti ose përmbajtja nuk është specifikuar ashtu si për të gjitha rastet e tjera nga shkronja "a" në shkronjën "f" të kësaj dispozite.

Gjykata çmon se Kuvendi nuk mund të miratojë një ligj të ri ose shtesa në një ligj të mëparshëm, të cilat kërkojnë "shumicë të cilësuar", me "shumicë të thjeshtë", sepse në këtë mënyrë ligjet që kërkojnë "shumicë të cilësuar" mund ta humbasin rëndësinë e tyre.

Për më tepër, Gjykata vlerëson se respektimi i kriterit kushtetues "shumicë e cilësuar", për sanksionimin e veprave penale në Kodin Penal, është edhe në funksion të parimit të sigurisë juridike. Ky parim ka si kërkesë të domosdoshme faktin që ligjet në tërësi duhet të garantojnë qartësi, parashikueshmëri dhe kuptueshmëri për individin, prandaj dhe praktika e përqendrimit të veprave penale vetëm në kod do të ishte një orientim i mirë për informimin e individëve për veprimet ose mosveprimet e tyre, të cilat mund të konsiderohen të kundërligjshme në fushën e së drejtës penale.

Si përfundim, Gjykata vlerëson se neni 15/a i ligjit nr.9794, datë 23.7.2007 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", nuk është miratuar sipas kushteve të kërkuara nga neni 81/2 i Kushtetutës, prandaj dhe kërkesa e paraqitur nga kërkuesi, në kuptim të nenit 145/2 të Kushtetutës, duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 145/2 të Kushtetutës dhe nenit 68 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Shpalljen si të papajtueshëm me Kushtetutën të nenit 15/a të ligjit nr.9794, datë 23.7.2007 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"".

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletore Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Sokol Sadushi, Petrit Plloçi, Admir Thanza, Sokol Berberi

Anëtare kundër: Vitore Tusha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	328 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 17.6.2011
Doli nga shtypi më 17.6.2011

Tirazhi: 1700 copë	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 40 lekë